



Studimet pasdiplomike-cikli i dytë

Tezë Masteri

“Analiza e performancës financiare të  
firmës “Banjat e Dibrës-Capa” për  
periudhën 2007-2017”

Kandidati:  
Ervin Papraniku

Mentori:  
Doc. Dr. Fitim Deari

Tetovë, Maj 2020

## Lista e tabelave

Tabela 1- Përpunim i autorit - 10 kompanitë në RVM me më së shumt investime në 2017.....	24
Tabela 2- Përpunim i autorit - Bilanci i gjendjes për periudhën 2007-2017, Banjat e Dibrës Capa .....	38
Tabela 3 – Përpunim i autorit, Bilanci i suksesit për periudhën 2007-2017, Banjat e Dibrës Capa .....	39
Tabela 4– Përpunim i autorit, Analiza horizontale, 2007-2010, Bilanci i gjendjes.....	40
Tabela 5– Përpunim i autorit, Analiza horizontale, 2010-2013, Bilanci i gjendjes.....	41
Tabela 6 – Përpunim i autorit, Analiza horizontale, 2013-2015, Bilanci i gjendjes.....	42
Tabela 7– Përpunim i autorit, Analiza horizontale, 2015-2017, Bilanci i gjendjes.....	43
Tabela 8 – Përpunim i autorit, Analiza horizontale, 2007-2010, Bilanci i suksesit.....	44
Tabela 9 – Përpunim i autorit, Analiza horizontale, 2010-2013, Bilanci i suksesit.....	45
Tabela 10– Përpunim i autorit, Analiza horizontale, 2013-2015, Bilanci i suksesit.....	46
Tabela 11– Përpunim i autorit, Analiza horizontale, 2015-2017, Bilanci i suksesit.....	47
Tabela 12– Përpunim i autorit, Analiza vertikale, Bilanci i gjendjes, Banjat e Dibrës Capa, 2007-2010 ....	48
Tabela 13 – Përpunim i autorit, Analiza vertikale, Bilanci i gjendjes, Banjat e Dibrës Capa, 2011-2014.....	49
Tabela 14– Përpunim i autorit, Analiza vertikale, Bilanci i gjendjes, Banjat e Dibrës Capa, 2015-2017 ....	50
Tabela 15– Përpunim i autorit, Analiza vertikale, Bilanci i suksesit, Banjat e Dibrës Capa, 2007-2010.....	51
Tabela 16– Përpunim i autorit, Analiza vertikale, Bilanci i suksesit, Banjat e Dibrës Capa, 2011-2015.....	52
Tabela 17– Përpunim i autorit, Analiza vertikale, Bilanci i suksesit, Banjat e Dibrës Capa, 2015-2017.....	53
Tabela 18- Përpunim i autorit, Pasuria e firmës përgjatë periudhës 2007-2017.....	54
Tabela 19 – Përpunim i autorit, Struktura e të hyrave, 2007 – 2017 .....	57
Tabela 20- Përpunim i autorit, Struktura e shpenzimeve, 2007 – 2017.....	58
Tabela 21 - Përpunim i autorit, Të hyrat, shpenzimet dhe fitimi neto kundrejt numrit të punëtorëve ....	59
Tabela 22- Përpunim i autorit, Raportet e likuiditetit, 2007 – 2017 .....	61
Tabela 23- Përpuni i autorit, Treguesit e qarkullimit të aktiveve, 2007 – 2017.....	62
Tabela 24- Përpunim i autorit, Treguesit e aftësisë pagueuse, 2007 – 2017.....	63
Tabela 25- Përpunim i autorit, Treguesit e rentabilitetit, 2007 – 2017.....	64
Tabela 26 – Përmbledhje e treguesëve financiarë.....	65

## Lista e figurave

Figura 1 - Përpunim i autorit, Bilanci dhe pasqyra e të ardhurave .....	17
Figura 2 - Maqedoni, kontributi direkt i turizmit në GDP .....	26
Figura 3 - Turizmi në Republikën e Maqedonisë Veriore – Liqeni i Ohrit.....	27
Figura 4 - Banjat Termale në vendin tonë .....	29
Figura 5- Trajtime Kurative në Banjat e Katlanovës .....	30
Figura 6- Investimet dhe modernizimi i strukturave hoteliere në Banjat e Dibrës Capa .....	32
Figura 7 - Përpunim i autorit, Anketë në lidhje me kënaqësinë e klientit .....	33
Figura 8- Përpunim i autorit, Pasuria e firmës, 2007-2017.....	54
Figura 9 - Përpunim i autorit, Pasuria fikse e firmës .....	55
Figura 10– Përpunim i autorit, Detyrimet, 2007-2017 .....	55
Figura 11 - Përpunim i autorit, Kapitali dhe rezervat, 2007-2017.....	56
Figura 12 - Përpunim i autorit, Të hyrat nga shitja dhe fitimi para tatimit, 2007-2017 .....	56
Figura 13 – Përpunim i autorit, Fitimi neto pas tatimit, 2007 – 2017 .....	57
Figura 14– Përpunim i autorit, Struktura e të hyrave, 2007 – 2017.....	58
Figura 15- Përpunim i autorit, Struktura e shpenzimeve, 2007 – 2017.....	59
Figura 16 - Përpunim i autorit, Të hyrat, të dalat dhe fitimi neto kundrejt numrit të punëtorëve .....	60
Figura 17- Përpunim i autorit, Raporti korrent & Testi acid, 2007 – 2017 .....	61
Figura 18- Përpunim i autorit, Kthimi nga aktivet (ROI) dhe parashikimi, 2007 – 2017.....	64
Figura 19 - Përpunim i autorit, Kthimi nga kapitali it vet (ROE) dhe parashikimi, (ROE), 2007-2017 .....	65

## Lënda e hulumtimit

Analiza financiare dhe më tej analiza e pasqyrave financiare paraqet procesin e vlerësimit dhe interpretimit të të dhënave financiare bashkë me informacione të tjera përkatëse, që të ndihmojë në realizimin e investimeve/financimeve dhe kështu marrjen e vendimeve afariste.

Analiza financiare mund të jetë e brendshme - për të vlerësuar çështje sikurse është performanca e punëtorëve, efikasiteti dhe efektiviteti i funksioneve apo operacioneve të ndërmarrjes si dhe politikën e kreditit, dhe e jashtme - për të vlerësuar investimet potenciale si dhe aftësinë kreditore të huamarrësve tanë.

Instrumentet që përdoren për të analizuar, krahasuar dhe interpretuar pasqyrat financiare janë treguesit financiarë/raportet financiare, që janë vegël apo mjet të analizës financiare dhe që përdoren nga analistët financiarë.

Koncepti apo termi *raport* nënkupton relacion matematikor ndërmjet një sasive ndaj një tjetre, ndërsa raporti apo treguesi financiar është krahasimi në mes një informacioni financiar me një tjetër, qoftë për të njëjtin subjekt afarist apo krahasim me subjektet tjera.

Analiza financiare, që nënkupton vlerësimin e performancës së një ndërmarrje apo biznesi, është e lidhur zakonisht me atë se sa mirë një ndërmarrje mund të përdorë mjetet e saj, kapitalin aksionar si dhe përgjegjësitë, të ardhurat dhe shpenzimet. Më tej, analiza e raporteve financiare paraqet mënyrën më të mirë për të vlerësuar performancën e një kompanie.

Përderisa gjendja financiare i referohet në mënyrë të drejtpërdrejt bilancit të gjendjes, performanca financiare ka të bëjë dhe lidhet me bilancin e suksesit (pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve). Por, padyshim që për analistin financiarë do të ishte me interes të dyja bashkë të analizohen, gjendja dhe performanca financiare pasi ato afekton njëri me tjetrin.

Megjithatë, shpesh përdorues të caktuar të informacionit kontabël interesohen për kategori të caktuar të tregueseve financiarë, për shembull, kreditori interesohet për shkallën e ngarkesës me borxh nga huamarrësi (biznesi) dhe nivelin e likuiditetit. Kështu që kreditori vlerëson nëse biznesi është i aftë të kthen kredinë në kohë, etj. Por, në anën tjetër, investitori apo pronari (aksionari) do të vlerësonte investimin e tij në kuadër të fitimit të realizuar kundrejt pasurisë së investuar.

Andaj, në këtë studim do të përqipemi që të analizojmë performancën financiare të firmës “Banjat e Dibrës-Capa” duke dhënë kështu konstatim dhe sugjerim për përmirësim të njëjtës në të ardhmen. Pra, lënda e hulumtimit është performanca financiare dhe analiza e saj dhe studimi

do të përdor pasqyrat financiare të shoqërisë aksionare “Banjat e Dibrës-Capa”, Dibër, në radhë të parë bilancin e suksesit dhe të dhënat tjera kontabël si nga bilanci i gjendjes dhe raportet tjera kontabël për periudhën 2007-2017.

Firma “Banjat e Dibrës-Capa” ofron shërbime mjekësore duke shfrytëzuar ujërat termo minerale kurativë dhe shërbime hotelerie. Disponon me dy lokalitet, gjegjësisht dy qendra mjekësore- hotelerie në fshatrat Banjisht dhe Kosovrast dhe me hotel luksoz në qendër të qytetit të Dibrës.

## **Hipotezat**

Hipotezat e ngritura në këtë studim reflektojnë nëse performanca e biznesit është përmirësuar ose përkeqësuar dhe lidhet ngushtë me pyetjen kërkimore se cila është performanca financiare e biznesit gjatë periudhës së analizuar e firmës “Banjat e Dibrës-Capa”.

Atëherë, meqenëse biznesi vitet e fundit ka bërë investime afatgjata në infrastrukturë dhe përmirësim të kushteve për klientët, rëndom aksionarët do të presin që edhe performanca financiare të jetë përmirësuar. Pra, parashtrajmë dy hipoteza:

*H1 – Performanca e firmës “Banjat e Dibrës-Capa” është përmirësuar si rezultat i investimeve në infrastrukturë.*

*H2 – Raporti risk dhe kthim nga investimet në infrastrukturë është në harmoni me pritshmërinë e vendimmarrësve menaxherial dhe aksionarëve.*

## **Metodologjia e hulumtimit**

Pjesa e metodologjisë së hulumtimit do të prezantohet dhe zbatohet më vonë në kuadër të këtij punimi masteri, por megjithatë këtu paraqitet vetëm pjesa bazë e shpjegimit dhe interpretimit për hapat dhe rrugën që studimi do të ndjekë.

Ky punim i masterit fillon nga e përgjithshmja, pra çfarë është bërë më herët apo nga pikëpamja teorike/empirike që më pastaj të vazhdon me rastin studimor për periudhën e përzgjedhur të analizës.

Rëndom, dy metodat shkencore të përdoruar zakonisht nga studiuesit janë metodat kualitative dhe kuantitative. Metoda kuantitative i referohet interpretimit matematikor dhe statistikor të rezultatit (si shitjet për shembull, 20,000 denarë; numri i të punësuarve: 10; etj.), kurse nga ana tjetër metoda shkencore kualitative ka të bëjë me të dhënat kualitative si bie fjala: gjinia e të punësuarve, kodimi i të dhënave, etj. Në kuadër të këtij punimi do të shfrytëzohen kryesisht teknikat dhe metodat e analizës kuantitative (sasiore), por do të zbatohen edhe pjesë të analizës kualitative (pyetëtori/intervista).

Të dhënat primare të gjendjes dhe performancës financiare të firmës gjatë viteve 2007 – 2017 do të merën si referencë dhe do të shërbejnë si pikënisje e studimit të rastit studimor. Të dhënat primare përfshijnë të dhënat kontabël që rrjedhin nga pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve apo bilanci i suksesit, bilanci i gjendjes si dhe raportet tjera kontabël-financiarë për vitin 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2013, 2014, 2015, 2016 dhe 2017 (pra periudha 2007 – 2017).

Këto të dhëna nuk janë përdorur më herët në një studim si ky punim masteri, andaj paraqesin të dhëna bazë dhe primare. Më tej do të shfrytëzohen të dhëna të tjera jo nga pasqyrat financiare, pra jo me karakter kontabël-financiar dhe në funksion të argumentimit apo mos argumentimit të rezultateve.

Firma e përfshirë në hulumtim është “Banjat e Dibrës-Capa”. Të dhënat kontabël do të përdoren për të llogaritur treguesit financiarë, për të realizuar analizën vertikale, horizontale, apo të tendencës. Pas llogaritjes së raporteve ato do të rregullohen dhe radhiten në një formë krahasuese me qëllim interpretimin më të saktë të rezultatit.

Pastaj, realizohet krahasimi kuantitativ i rezultatit që nënkupton llogaritjen matematikore të raporteve-treguesve financiare, por njëkohësisht duke analizuar edhe tendencën e tyre. Për më

tepër krahasimi kuantitativ do të mbështetet nga komentet dhe diskutimet tjera kualitative dhe informacionet e përfituara nga analiza e pasqyrave financiare.

Për të analizuar raportet financiare përdoret metoda krahasuese, e cila nënkupton krahasimin e rezultateve përfundimtare apo të dhënave që kemi në dispozicion. Me anë të kësaj metode krahasohen rezultatet e një subjekti (firmës në këtë rast) me një tjetër për të parë se cila është më e mirë si dhe të një periudhe me një tjetër (krahasimi i të njëjtës firmë). Në rastin konkret do të krahasohen raportet financiare të firmës për të parë se si ka ndryshuar performanca financiare e firmës gjatë kësaj periudhe, para dhe pas investimit, apo me normat-standardet e njohura, bie fjala, rregulli i gishtit të madh, etj.

Teknika të ndryshme do të përdoren për të analizuar pasqyrat financiare dhe për të theksuar rëndësinë krahasuese dhe lidhëse të dhënave kontabël të prezantuara dhe kështu për të vlerësuar performancën financiare të biznesit në fjalë.



## Abstrakti

Në këtë studim do të realizohet analiza e pasqyrave financiare për firmën “Banjat e Dibrës – Capa”, Dibër, duke u përqendruar në performancën financiare për periudhën 2007-2017.

Firma “Banjat e Dibrës-Capa” ofron shërbime mjekësorë duke shfrytëzuar ujërat termo minerale dhe shërbime hotelerie. Disponon me dy lokalitete, gjegjësisht dy qendra mjekësore-hotelerie në fshatrat Banjisht dhe Kosovrast në rrethin e Dibrës si dhe me hotel luksoz dhe restorant në qendër të qytetit.

Rëndom, analiza e performancës financiare nuk mund të realizohet veçmas analizave të tjera financiare përfshirë këtu bilancin i gjendjes, por edhe të dhënat tjera kontabël të cilat janë shfrytëzuar në këtë punim masteri.

Marrë në përgjithësi dhe konsideratë aktivitetin afarist dhe specifikat përkatëse biznesore, firma ka realizuar një progres në terma të treguesve dhe rezultateve që janë fituar në këtë studim për periudhën e analizës.

Rezultatet e fituara tregojnë se megjithatë firmat ka arritur të ketë një rritje biznesore dhe njëkohësisht duke mbajtur një nivel të kënaqshëm të likuiditetit dhe stabilitetit financiar.

Në vazhdim, performanca financiare ka evoluar përgjatë periudhës së analizës në kuptim të përmirësimit si produkt i një menaxhimi të suksesshëm dhe nga investimet e realizuara afatgjata në infrastrukturë. Performanca financiare vitet e fundit madje mund të thuhet se është mjaft e kënaqshme duke u matur dhe prezantuar përmes treguesve bazë financiare si: ROI, ROE, fitimi marginal bruto, fitimi marginal neto, etj.

***Fjalët kyçe:*** performanca financiarë, treguesit, “Banjat e Dibrës – Capa”, korrelacioni.

## **Abstract**

This study will analyze the financial statements for the firm "Capa Spa Resorts", Debar, focusing on financial performance for the period 2007-2017.

The firm "Capa Spa Resorts" offers medical services by utilizing thermal mineral waters and hotel services. It has two locations, namely two medical-catering centers in the villages of Banjisht and Kosovrast in the district of Dibra as well as a luxury hotel and restaurant in the center of the city.

Normally, the financial performance analysis cannot be performed separately from other financial analyzes including the balance sheet, but also other accounting data used in this master thesis.

Considering the overall business activity and related business specifics, the firm has made progress in terms of indicators and results obtained in this study for the analysis period.

The obtained results show that however, firms have achieved business growth while maintaining a satisfactory level of liquidity and financial stability.

In addition, financial performance has evolved over the analysis period in terms of improvement as a product of successful management and of long-term investments in infrastructure. Financial performance in recent years can even be said to be quite satisfactory by measuring and presenting through the key financial indicators such as: ROI, ROE, gross marginal profit, net marginal profit, etc.

**Keywords:** financial performance, indicators, "Capa Spa Resorts", correlation.

## Апстракт

Оваа студија ќе ги анализира финансиските извештаи за фирмата „Дебарски бањи - Цапа“, Дебар, фокусирајќи се на финансиската перформанса за периодот 2007-2017 година.

Фирмата „Дебарски бањи - Дебар“ нуди медицински услуги со користење на термално минерални води и хотелски услуги. Има две локации, имено два медицинско-угостителски центри во селата Бањист и Косовраст во округот Дебар како и луксузен хотел и ресторан во центарот на градот.

Нормално, анализата на финансиската перформанса не може да се изврши одделно од другите финансиски анализи, вклучително и билансот на состојба, но исто така и другите сметководствени податоци користени во оваа магистерска теза.

Земајќи ги предвид целокупната деловна активност и сродните деловни специфики, фирмата оствари напредок во однос на индикаторите и резултатите добиени во оваа студија за периодот на анализа.

Резултатите покажуваат дека, сепак, фирмите постигнале раст на бизнисот, додека одржуваат задоволително ниво на ликвидност и финансиска стабилност.

Покрај тоа, финансиските перформанси се развиле во текот на периодот на анализа, во смисла на подобрување, како производ на успешно управување и долгорочни инвестиции во инфраструктурата. Финансиските перформанси во последните години дури може да се каже дека се доста задоволителни со мерење и презентирање преку клучните финансиски пазари како што се ROI, ROE, бруто маргинална добивка, нето маргинална добивка и др.

**Клучни зборови:** финансиска перформанса, индикатори, „Дебарски бањи - Цапа“, корелација.

## Përmbajtja

Lista e tabelave .....	2
Lista e figurave:.....	3
Lënda e hulumtimit.....	4
Hipotezat.....	6
Metodologjia e hulumtimit.....	7
Abstrakti.....	9
Abstract.....	10
Апстракт .....	11
KREU I. HYRJE.....	13
1.1. Rëndësia e studimit.....	13
1.2. Objektivat e studimit.....	14
1.3. Definimi i problemit .....	14
KREU II. PERFORMANCA FINANCIARE, DISA PIKËPAMJE TEORIKE.....	16
2.1. Pasqyrat financiare dhe lidhje e tyre .....	16
2.2. Rëndësia dhe roli i analizës së pasqyrave financiare në vendimmarrjen afariste .....	19
2.3. Performanca financiare dhe treguesit financiar .....	20
2.4. Studimet paraprake dhe rezultatet empirike .....	22
KREU III. TË DHËNAT DHE METODOLOGJIA E HULUMTIMIT.....	26
3.1. Industria, burimet e të dhënave dhe përshkrimi i firmës.....	26
3.2. Pyetjet dhe hipotezat e hulumtimit.....	34
3.3. Metodologjia e hulumtimit.....	34
KREU IV. ANALIZA DHE DISKUTIMI I REZULTATEVE .....	36
4.1. Analiza horizontale .....	36
4.2. Analiza vertikale.....	48
4.3. Analiza e trendit.....	53
4.4. Treguesit financiar dhe përmbledhja e tyre .....	60
4.5. Diskutimi i rezultateve dhe implikimi biznesor .....	66
KREU V. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME .....	70
5.1. Përfundimet.....	70
5.2. Rekomandimet .....	72
5.3 Kufizimet e punimit dhe sugjerimet për të ardhmen .....	72
Referencat.....	73

## KREU I. HYRJJE

### 1.1. Rëndësia e studimit

Vlerësimi i performancës financiare është i njohur dhe inkorporuar shpesh në diskutimet e përditshme dhe strategjike të aksionarëve dhe investitorëve kryesisht, por pa anashkaluar në këtë rast menaxherët. Vlerësimi i performancës financiare si problematik dhe temë është pjesë bazike e fushës së analizës së pasqyrave financiare ku vetë kjo e fundit është një sistem për procedimin e të dhënave kontabël-financiarë, i dizajnuar për të furnizuar me të dhëna dhe informacione vendimmarrësit.

Nëpërmjet analizës financiare dhe më tej përmes analizës së pasqyrave financiare, investitorët mundohen që të parashikojnë rrjedhjet e ardhshme të parave si dhe të vlerësojnë profitabilitetin e investimeve të realizuara ose që pretendojnë në biznes. Andaj, gjykohet se ky punim do të trajton edhe pikëpamjen teorike edhe atë praktike në radhë të parë duke prezantuar se cila është performanca financiare e biznesit në fjalë; cilët janë anët e dobëta dhe të forta të firmës kundrejt më shumë krahasimeve; si të përmirësohen treguesit e performancës financiare në të ardhmen, etj.

Përveç analizave të integruara dhe rezultateve që do të nxirren, studimi ka për qëllim të ndihmon vendimmarrjen menaxheriale të këtij biznesi duke dhënë edhe disa sugjerime/rekomandime në të ardhmen në funksion të përmirësimit të performancës financiare. Andaj, ky studim mundohet të ofron një evidencë sa empirike dhe praktike po aq edhe akademike duke ofruar kështu një bazë reference për studimet e ardhshme në këtë fushë, qoftë madje edhe si aparat metodologjik dhe shkencor.

Prandaj, si në çdo punim apo kërkim shkencor është në interes të lexuesit të diskutohet dhe prezantohet pjesa apo komponenti që lidhet me rëndësinë e hulumtimit shkencor siç është edhe ky punim masteri. Punimi në fjalë bazohet në analizën dhe vlerësimin e performancës financiare për rastin studimor të veçuar dhe periudhën e selektuar. Punimi duke u mbështetur në gjetjet, metodologjinë dhe rezultatet e mëhershme empirike në këtë fushë studimi, mundohet të reflekton një vlerësim sa më të drejtë duke dhënë njëherit edhe sugjerime për përmirësime të mundshme.

Gjykojmë se si studim do të jetë jo vetëm një kontribut modest shkencor, por edhe një reflektim dhe këshillë dhënie për menaxhimin më të saktë të financave të firmës “Banjat e Dibrës – Capa”. Si i tillë do të ju ndihmonte në vendimmarrje si përdoruesve të brendshëm ashtu edhe atyre të jashtëm të informacionit kontabël. Padyshim, që janë vetë pronarët apo investitorët ato që në radhë të parë janë të interesuar për përmirësimin e performancës financiare.

## 1.2. Objektivat e studimit

Në vlerësimin e performancës financiare analisti financiar mund të definon objektiva të ndryshme që dëshiron të arrijë përmes analizave të ndryshme financiare. Gjithsesi, do të bënte një rangim të tyre sipas rasteve dhe kërkesave që ka pala e interesuar. Andaj me të drejtë autori Xhafa (2010) thekson se: *“analiza e pasqyrave financiare nënkupton këndvështrime të ndryshme nga persona të ndryshëm, gjithmonë në varësi të interesave të tyre të veçanta. Kreditorët, investitorët aktual dhe vetë menaxherët e shoqërisë përqendrohen në pjesë të ndryshme të analizës për të gjetur në to përgjigjet e pyetjeve që janë më shqetësuese për ta.”*<sup>1</sup> (Xhafa, 2010)

Prandaj, në këtë studim, nga pikëpamja e një studiuesi do të përpiqem që të analizojë pasqyrat financiare të ndërmarrjes “Banjat e Dibrës – Capa”, për periudhën 2007-2017, me qëllim që të nxirret në sipërfaqe se çfarë performance financiare subjekti afarist aktualisht ka dhe mundësisht të jepën disa rekomandime për përmirësim të treguesve në të ardhmen.

Me fjalë të tjera, studimi ka për qëllim të ekzaminon tregues të caktuar të performancës financiare shumë të vlefshëm për vendimmarrjen si nga përdoruesit e brendshëm ashtu edhe ato të jashtëm. Kështu do të elaborohet përmes analizave të caktuara financiare-kontabël nëse informacioni kontabël-financiar si instrument ka ndihmuar, në çmasë dhe si, vendimmarrjen afariste, konkretisht të menaxherëve.

Informacioni i tillë kontabël dhe financiar rrjedh nga vlerësimi i gjendjes dhe performancës së biznesit. Pikërisht, në këtë studim analiza përqendrohet veçmas në performancën financiare, por gjithsesi që performanca financiare ndikohet dhe ndikon në treguesit tjerë financiarë siç janë në radhë të parë (në planin mikro) treguesit e bilancit të gjendjes, etj.

Të dhënat e selektuara për periudhën 2007-2017 do të analizohen dhe përmes teknikave dhe metodologjisë së caktuar do të vihet në disa përfundime dhe rekomandime të caktuara që do të mund ti shërbenin në radhë të parë menaxhmentit të vetë firmës, por pa diskutim që mund t’ju shërbejnë edhe grupeve të tjera të interesit.

## 1.3. Definimi i problemit

Në këtë studim është marrë për analizë një ndërmarrje nga sektori privat. Ndërmarrja “Banjat e Dibrës – Capa”, dikur ka qenë ndërmarrje publike shtetërore, ndërsa me privatizimin ka pësuar ndryshime si në strukturë ashtu dhe në menaxhment. Pikërisht kjo strukturë dhe ky menaxhment i ri kanë sjellë ndryshimin në qasjen e të bërit biznes dhe më konkretisht në mënyrën e operimit të ndërmarrjes. Si rrjedhojë, veçanërisht gjatë periudhës kohore e cila merret në studim, firma “Banjat e Dibrës – Capa” ka realizuar investime në të dy lokalitetet në të cilat ofron shërbimet e saja, me qëllim të përmirësimit të kushteve për klientët. Këto investime kryesisht kanë qenë në infrastrukturë, personel dhe zgjerimin e kapacitetit të shërbimeve që ofrohen.

---

<sup>1</sup> Halit Xhafa, “Drejtimi Financiar”, Tiranë, 2010, fq. 72.

Si pasojë e investimeve të realizuara, është në pritshmëritë e menaxhmentit dhe të aksionarëve të kompanisë që gjendja financiare të jetë përmirësuar pas investimeve. Kjo duhet të ketë afektuar kështu edhe performancën financiare të biznesit dhe me të edhe kthimin e pritshëm të aksionarëve.

Megjithatë, janë një numër i konsiderueshëm i faktorëve dhe variabileve që ndikojnë në realizimit e qëllimit të mësipërm. Për shembull, sipas të dhënave jo zyrtare, niveli i çmimeve është relativisht i lartë në raport me të ardhurat mesatare dhe mundësitë e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë Veriore por edhe vendeve fqinje si Kosova dhe Shqipëria, duke patur parasysh se një pjesë e konsiderueshme e klientëve janë pikërisht nga vendet fqinje.

Nëpërmjet këtij studimi do të vlerësojmë nëse performance financiare e ndërmarrjes është përmirësuar si pasojë e investimeve të realizuara përkundrejt problematikës së lartpërmendur dhe do të japim rekomandimet tona gjithmonë me qëllim të përmirësimit të rezultatit financiar por edhe raporteve me klientët të cilët padyshim që afektojnë treguesit e biznesit.

## KREU II. PERFORMANCA FINANCIARE, DISA PIKËPAMJE TEORIKE

### 2.1. Pasqyrat financiare dhe lidhje e tyre

Padyshim që ekzistojnë definime të ndryshme si teorike ashtu edhe praktike për pasqyrat financiare. Për shembull, (Govori, 2012) thekson se: “pasqyrat financiare janë prezantime financiare të strukturuar të cilat ofrojnë informacion në lidhje me gjendjen financiare dhe transaksionet e kryera nga ana e ndërmarrjes për një periudhë të caktuar kohore.”<sup>2</sup>

Procesi i kontabilitetit apo sistemi i raportimit financiar, të cilat gjenerojnë informacion financiar për përdoruesit e jashtëm duhet të përfshijnë ato pasqyra kryesore financiare të cilat janë të domosdoshme për tu përgatitur dhe raportuar siç specifikohet në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK). Sipas SNK1 apo në gjuhën angleze IAS1, një paketë e plotë e pasqyrave financiare përmban: <sup>3</sup>(Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit)

- një bilanc;
- një pasqyrë të ardhurave dhe shpenzimeve;
- një pasqyrë e ndryshimeve në kapitalin, ku tregohen,
  - të gjitha ndryshimet në kapitalin neto, ose
  - ndryshimet në kapitalin neto, të cilat nuk kanë ardhura nga transaksionet me zotëruesit e kapital neto të kryera nga pozita e tyre si të tillë;
- një pasqyrë e fluksit të mjeteve monetare; dhe
- shënimet që përfshijnë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme si dhe shënimet e tjera shpjeguese.

Me qëllim njohjen dhe interpretimin e rezultatit të fituar nga analizat e performancës financiare, konsiderojmë se duhet një përshkrim i përmbledhur i burimeve – bilanceve nga vinë të dhënat kontabël dhe cila është lidhja në mes tyre. Andaj, në vazhdim prezantohen bilancet apo pasqyrat kryesore financiare si burim i të dhënave për analistin financiarë.

#### **Bilanci kontabël**

Pasqyra e bilancit kontabël tregon gjendjen financiare të firmës në një kohë të caktuar, prandaj dhe zakonisht i referohemi si bilanci i gjendjes. Kjo pasqyrë na tregon mjetet që posedon firma (aktivet), mjetet që firma u detyrohet kreditorëve (detyrimet), dhe kapitalin vetanak që paraqet shumën që fitohet kur nga aktivet zbrisim detyrimet. Pra, konkretisht aktivet janë diçka që firma zotëron, si për shembull: tokë, ndërtesa, pajisje, mjete në para dhe ekuivalent të parasë,

<sup>2</sup>Fadil Govori, “Analiza e pasqyrave financiare: Përdoruesit e treguesve financiarë”, Pejë, 2012, fq. 4.

<sup>3</sup> Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit – SNK/IAS1, fq. 2.

[http://www.kkk.gov.al/foto/uploads/File/SNK\\_Requirements/IAS%201%20Paraqitja%20e%20Pasqyrave%20Financiare.pdf](http://www.kkk.gov.al/foto/uploads/File/SNK_Requirements/IAS%201%20Paraqitja%20e%20Pasqyrave%20Financiare.pdf)



mjete transportuese, etj., ndërsa detyrimet paraqesin obligime-borxhe që firma i ka ndaj palëve të tjera, si për shembull, llogaritë e pagueshme, detyrimet nda kredisë bankare, etj.

### Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Nga vetë emri pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, kjo pasqyrë tregon të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe fitimin apo humbjen e realizuar gjatë një periudhe të caktuar. Megjithatë, për ta definuar më së miri, do ti referohemi autorit Xhafa (2010), i cili për më tepër ofron një krahasim si dhe lidhjen që ka pasqyra e të ardhurave me bilancin kontabël. Sipas tij, “pasqyra e të ardhurave shpreh gjendjen e veprimtarisë operative të një shoqërie për një periudhe kohore të dhënë, për shembull për një vit kalendarik. Pasqyra e të ardhurave është një fotografi në lëvizje, pra i ngjan një filmi, ndërsa bilanci është fotografi e çastit. Bilanci tregon thjesht sa e pasur apo e varfër është shoqëria, ndërsa pasqyra e të ardhurave tregon si ka qenë shoqëria vitin e kaluar. Pasqyra e të ardhurave shërben si urë ndërmjet dy bilanceve të njëpasnjëshëm.”<sup>4</sup> (Xhafa, 2010)




Figura 1 - Përpunim i autorit, Bilanci dhe pasqyra e të ardhurave

Burimi: Halit Xhafa, “Drejtimi Financiar”, Tiranë, 2010, fq. 46.

Sipas (Dhamo, 2005), “të ardhurat janë rritje të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës kontabël në formën e të hyrave ose rritjeve të aktiveve ose në formën e uljes së detyrimeve që çojnë në rritje të kapitalit të vet, përveç rritjes së kapitalit që vjen nga kontributet e kapitalit të pjesëmarrësve. Ndërsa shpenzimet, janë zvogëlimet në përfitimit ekonomike gjatë periudhës

<sup>4</sup>Halit Xhafa, “Drejtimi Financiar”, Tiranë, 2010, fq. 45.

kontabël në formën e të hyrave ose rritjes së aktiveve ose në formën e uljes së detyrimeve që çojnë në rritjen e kapitalit të vet, përveç rritjeve të kapitalit që vjen nga kontributet e kapitalit të pjesëmarrësve.”<sup>5</sup>

E ardhura neto apo humbja neto është dallimi që rezulton në mes të ardhurave të përgjithshme dhe shpenzimeve të përgjithshme. Domethënë, nëse të ardhurat janë më të larta se shpenzimet, kemi fitim neto i cili më pas i shtohet fitimit të pashpërndarë në bilanc, ndërsa në rast të kundërt kemi humbje neto dhe si rezultat ulje të fitimit të pashpërndarë, nëse kështu vendoset të shpërndahet rezultati financiar nga biznesi.

### **Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare**

Pasqyra e tretë e rëndësishme e cila paraqitet në raportin vjetor kontabël të firmës është pasqyra e fluksit të mjeteve monetare. Sipas SNK7, “informacioni rreth fluksit monetar të një njësie ekonomike është i dobishëm për të pajisur përdoruesit e pasqyrave financiare me një informacion bazë për të vlerësuar aftësinë e një njësie ekonomike për të gjeneruar mjete monetare dhe ekuivalent të tyre dhe për të vlerësuar nevojat e njësisë ekonomike për të përdorur këto flukse monetare.”<sup>6</sup> (Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit)

### **Pasqyra e ndryshimeve në kapital**

Pasqyra e katërt por jo më pak e rëndësishme, është pasqyra e ndryshimeve në kapital. Kjo pasqyrë, nga vetë emri, i ofron përdoruesit informacion në lidhje me ndryshimet në kapitalin e pronarit apo aksionarëve për një periudhë të caktuar kontabël. Pasqyra e ndryshimeve në kapital zakonisht i bashkëngjitet pasqyrës së të ardhurave pasi që përpilon kapitalin e pronarit dhe është mjaftë domethënëse për pronarët (aksionarët) e biznesit.

Krahas pasqyrave standarde financiare, në trajtimin e gjendjes financiare të biznesit, janë të rëndësishme edhe seksionet e tjera të raportit vjetor të njohura edhe si shtojca të bilanceve (të dhënat e veçanta). Këto seksione përfshijnë disa të dhëna të rëndësishme, si fushat e veprimtarive operative, shënime plotësuese, informacione shtesë dhe raportin e auditimit.

Padyshim që përdoruesit e pasqyrave financiare, për të patur një ide të qartë mbi situatën financiare të firmës, duhet që të marrë në konsideratë të gjitha pasqyrat financiare të firmës. Për më tepër që ato janë edhe në raport të ngushtë me njëra tjetrën. Lidhjen që ekziston mes pasqyrave financiare e shpjegon autori Govori (2012) si vijon: “pasqyrat financiare janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën, sepse marrin vlera nga një tjetra. Kështu, p.sh., bilanci i gjendjes merr nga pasqyra e ndryshimit të kapitalit, kapitalin në datën e ndërtimit të bilancit (në fund të periudhës), pasqyra e ndryshimeve në kapital merr nga pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve shumë të ardhurës neto të realizuar gjatë periudhës, apo pasqyra e flukseve të arkësmerr nga pasqyra e lëvizjes së kapitalit investimet dhe tërheqjet e pronarit, etj. Të katër

<sup>5</sup> Sotiraq Dhama, “Kontabilitet i Avancuar”, Tiranë, 2005, fq. xi.

<sup>6</sup> Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit - SNK/IAS7, fq.1.

[http://www.kkk.gov.al/foto/uploads/File/SNK\\_Requirements/IAS%207%20Pasqyra%20e%20fluksit%20monetar.pdf](http://www.kkk.gov.al/foto/uploads/File/SNK_Requirements/IAS%207%20Pasqyra%20e%20fluksit%20monetar.pdf)

pasqyrat japin në formë të plotë dhe sistematike informacionet që u nevojiten palëve të interesuara për një ndërmarrje të caktuar, pavarësisht nga madhësia e saj.”<sup>7</sup> (Govori, 2012)

## **2.2. Rëndësia dhe roli i analizës së pasqyrave financiare në vendimmarrjen afariste**

Analiza e pasqyrave financiare sot paraqet një nga aktivitetet thelbësore dhe të domosdoshme në të bërit biznes. Si proces, analiza e pasqyrave financiare është definuar në mënyra të ndryshme nga shumë autorë, ndërsa në mënyrë më të përmbledhur Karapici (2002) e përkufizon kështu: “Analiza e pasqyrave financiare është një proces gjykimi që synon të vlerësojë pozicionin financiar të kaluar dhe atë të tashmin në një firmë. Objektivi parësor i saj është përcaktimi, parashikimi dhe vlerësimi më i mirë i kushteve ekonomike dhe performancës në të ardhmen. Prosesi është përdorimi i mjeteve dhe i teknikave analitike mbi dokumentet financiare dhe të dhënat, me qëllim që me anë të tyre të realizohet matja dhe lidhjet që janë të rëndësishme dhe të dobishme për marrjen e vendimeve. Me fjalë të tjera, analiza financiare është proces i të menduarit, të punuarit dhe të analizuarit mbi të dhënat kontabël për të krijuar një sistem treguesish (vlerësues) për marrjen e vendimeve dhe jo të bazohet në hamendje.”<sup>8</sup> (Karapici, 2002)

Pasqyrat financiare janë objekt studimi apo analize për grupe të ndryshme në varësi të interesave të tyre. Kreditorët kryesisht janë të interesuar mbi aftësinë e biznesit për pagimin e borxheve. Kreditorët afatshkurtër, të tillë si furnitorët, shqetësohen për aftësinë e firmës për të paguar borxhet dhe duan të jenë të sigurt se biznesi nuk ka probleme likuiditeti. Kreditorët afatgjatë, të tilla si bankat ose zotëruesit e obligacioneve, interesohen mbi aftësinë e firmës për të paguar interesin dhe shumën bazë për fondet e mara hua.<sup>9</sup> (Xhafa, 2010)

Investitorët gjithashtu janë të interesuar në analizën e pasqyrave financiare të firmës ose firmave në të cilat ata janë të interesuar të investojnë kapitalin e tyre. Ata i vlerësojnë aksionet duke e bazuar në pasqyrat financiare, por edhe mbi bazën e të dhënave nga tregu i aksioneve. Entitetet afariste dhe financiare që e financojnë biznesin gjithashtu kanë nevojë të analizojnë pasqyrat financiare me qëllim të marrjes së vendimeve afariste. Për shembull, nëse firma financohet nga një bankë, menaxherët e bankës duhet që të sigurohen se firma është në gjendje dhe ka kapacitet të mjaftueshëm që të kthejë shumën e huazuar bashkë me interesin përpara se të aprovojnë një kredi bankare.

Menaxherët e firmës, të caktuar nga pronarët e ndërmarrjes për të udhëhequr me biznesin kanë nevojë për informacion në lidhje me situatën financiare të ndërmarrjes për arritjen e efikasitetit dhe marrjen e vendimeve efektive, si në plan afatshkurtër ashtu edhe atë afatgjatë.

Nëpërmjet analizës financiare ata mund tu japin përgjigje pyetjeve në lidhje me mënyrën e menaxhimit të firmës, nëse gjendja aktuale është në përputhje me parashikimet e tyre dhe pritshmëritë e aksionarëve, raporti risk/kthim për aksionaret, etj. Analiza e pasqyrave financiare i

<sup>7</sup> Fadil Govori, “Analiza e pasqyrave financiare: Përdoruesit e treguesve financiarë”, Pejë, 2012, fq. 6.

<sup>8</sup> Vjollca Karapici, “Analiza Financiare”, Tiranë, 2002, fq 9

<sup>9</sup> Halit Xhafa, “Drejtimi financiar”, Tiranë 2010, fq 72

mundëson menaxhmentit të firmës të bëjë korrigjimet e nevojshme në rast të devijimeve të mundshme nga parashikimi dhe tu përgjigjet kërkesave dhe ndryshimeve në treg.

Pra, analiza e pasqyrave financiare ofron informacione thelbësore përmes të cilave menaxhmenti i firmës, aksionarët si dhe të gjithë palët e tjera që kanë interes mbi biznesin përcaktohen për vendimet e ardhshme afariste duke ulur njëkohësisht pasigurinë në vendimmarrje.

### **2.3. Performanca financiare dhe treguesit financiar**

Performanca financiare si nocion është definuar nga shumë autorë në mënyra ndryshme, por të gjitha përkufizimet në thelb kanë kuptimin e njëjtë, kështu që shkurtimisht mund të themi se “me performancë financiare nënkuptohet gjendja e marrëdhënieve financiare të subjektit për një periudhë të caktuar. Performanca financiare mat se si dhe sa ndërmarrja i shfrytëzon mjetet e saja për të gjeneruar të ardhura. Nocioni performancë financiare gjithashtu përdoret për të treguar se sa e shëndoshë është ndërmarrja financiarisht.”<sup>10</sup>

Nga ajo që u tha më sipër, mund të themi se matja e performancës financiare është e vendimtare për suksesin e ndërmarrjes. Matja e performancës bëhen përmes llogaritjes dhe analizës së treguesve financiar, krahas llojeve tjera të analizave si horizontale, vertikale, e tendencës, etj. Sipas (Xhafa, 2010), treguesit e raportimit financiar mund të grupohen në këto kategori:<sup>11</sup>

- raportet e likuiditetit,
- raportet e përdorimit të aktiveve,
- raportet e aftësisë paguese (të levës financiare dhe borxhit),
- raportet e rentabilitetit dhe
- raportet e tregut.

#### **Raportet e likuiditetit**

Likuiditeti i një firme përfaqëson kapacitetin e saj potencial për të përballuar detyrimet e saj. Dimensioni i këtij kapaciteti njihet jo nga vlera e kapitalit qarkullues, por nga një krahasim ndërmjet madhësive së pasurive disponibël për pagimin e borxheve dhe borxheve që duhet të paguhet.<sup>12</sup> (Karapici, 2002) Mungesa e likuiditetit të firmës mund ta shpie atë në falimentin, sidomos gjatë periudhave të krizës ekonomike. Megjithatë, edhe norma e lartë e likuiditetit nuk është një indikator i preferueshëm pasi shuma të mëdha në para nënkupton që firma ka një normë të ulët të kthimit.

Literatura por edhe praktika menaxheriale e financave si matës kryesor dhe të shpeshtë të likuiditetit të firmës e cilëson dhe përdor:

- Kapitalin punues – fitohet kur nga aktivet afatshkurtra zbriten detyrimet afatshkurtra.

<sup>10</sup> <https://www.investopedia.com/terms/f/financialperformance.asp>.

<sup>11</sup> Halit Xhafa, “Drejtimi Financiar”, Tiranë, 2012, fq. 75.

<sup>12</sup> Vjollca Karapici, “Analiza Financiare, Tiranë, 2002, fq. 136.

- Raportin korrent – tregon aftësinë e firmës për të shlyer borxhin afatshkurtër me aktive afatshkurtra dhe fitohet duke pjesëtuar aktivet afatshkurtra me detyrimet afatshkurtra.
- Raporti i likuiditetit (testi acid) – paraqet treguesin më të qartë të likuiditetit, pasi merr në konsideratë vetëm aktivet më likuide. Pra, për llogaritjen e këtij raporti, nga aktivet afatshkurtra minusohen inventarët dhe shpenzimet e parapaguara dhe më pas pjesëtohet shuma e gjetur me detyrimet afatshkurtra.

### **Raportet e përdorimit të aktiveve dhe raportet e aftësisë paguese**

Raportet e përdorimit të aktiveve, nga vetë emri, tregojnë efikasitetin e firmës në përdorimin e aktiveve për të gjeneruar të ardhura. Sa më i lartë të jetë ky raport, aq më me efektivitet i menaxhon biznesi aktivet e tij në terma të përgjithshëm.

Nga raportet e përdorimit të aktiveve zakonisht përdoret:

- Qarkullimi i llogarive të arkëtueshme – tregon sa herë brenda një viti arkëtohen llogaritë e arkëtueshme
- Periudha mesatare e arkëtimit – tregon numrin e ditëve për sa kohë arkëtohen llogaritë e arkëtueshme.
- Raporti i qarkullimit të inventarit – tregon raportin mes shitjeve dhe inventarit.
- Raporti i qarkullimit të aktiveve gjithsej – ky raport tregon nëse firma i menaxhon me efikasitet aktivet e saja për të gjeneruar të ardhura. Fitohet kur nga shitjet pjesëtohen aktivet gjithsej.

### **Raportet e aftësisë paguese (të levës financiare dhe borxhit)**

Raportet e aftësisë paguese, tregojnë madhësinë e borxhit në strukturën e kapitalit dhe ato rëndom përfshijnë:

- Raporti i borxhit gjithsej ndaj aktiveve gjithsej,
- Raporti i borxhit gjithsej ndaj kapitalit aksionar dhe
- Raporti i mbulimit të interesave.

### **Raportet e rentabilitetit dhe raportet e tregut**

Raportet e rentabilitetit masin aftësinë e ndërmarrjes apo biznesit për të gjeneruar të ardhura dhe kthime të larta përmes efikasitetit dhe efektivitetit të operacioneve të saj, duke shfrytëzuar burimet që ka në dispozicion. Matësit kryesor të rentabilitetit janë:

- Fitimi marginal bruto është përqindja e çdo monedhe të realizuar nga shitja që i mbetet pasi shoqëria ka paguar shpenzimet (pa interesin dhe tatimet)<sup>13</sup>. (Xhafa, 2010)

$$\text{Fitimimargjinalbruto} = \frac{\text{Fitimibruto}}{\text{Shitjetneto}}$$

- Fitimi marginal neto tregon të ardhurat e gjeneruara pasi të jenë paguar interesi bashkë me tatimet.

<sup>13</sup>Halit Xhafa, “Drejtimi Financiar”, Tiranë, 2012, fq. 85.

$$\text{Fitimimargjinalneto} = \frac{\text{Fitimineto}}{\text{Shitjetneto}}$$

- Kthimi nga aktivet gjithsej (ROI) tregon sa euro fitim neto realizohet nga një monedhë investime apo aktive. Ai jep një pamje nëse menaxhimi është eficient në përdorimin e burimeve që ka në dispozicion për të siguruar fitim.<sup>14</sup> (Xhafa, 2010)

$$\text{Kthimíngaaktivetgíthsej(ROI)} = \frac{\text{Fitimineto}}{\text{Aktivetgíthsejmesatar}}$$

- Kthimi nga kapitali i vet (ROE) mat kthimin mesatar ndaj kapitalit të vet, pra kontributin ndaj pasurisë së aksionarëve. Ajo pasqyron normën e kthimit të fituar nga investimet e aksionarëve.<sup>15</sup> (Xhafa, 2010)

$$\text{Kthimíngakapitaliivet(ROE)} = \frac{\text{Fitiminetonëdispoziciontëaksionerëve}}{\text{Kapitaliaksionarmesatar}}$$

Më tej, raportet e tregut shprehin perceptimin e tregut ndaj fitimeve të ardhshme të firmës gjë që shprehet në çmimin e tregut të aksioneve të zakonshme. Këto raporte dhe ato që lidhen me dividendëve krijojnë një lidhje midis çmimit të aksionit dhe dividendëve, të ardhurave dhe vlerës kontabël të aksionit.

Të ardhurat ose e ardhura për aksion (EPS) është raporti për të cilin janë më të interesuar investitorët. EPS përcaktohet duket pjesëtuar fitimin neto me aksionet e zakonshme në qarkullim.<sup>16</sup> (Xhafa, 2010)

$$\text{EPS} = \frac{\text{Fitimineto} - \text{Dividentëtepreferuar}}{\text{Aksionetëzakonshmenëqarkullim}}$$

Në anën tjetër, raporti çmim/ të ardhura (P/E) tregon relacionin mes çmimit të tregut për aksion dhe të ardhurave për aksion.

$$\text{P/E} = \frac{\text{Çmimitregutpëraksion}}{\text{Tëardhuratpëraksion}}$$

## 2.4. Studimet paraprake dhe rezultatet empirike

Padyshim që qëllimi i pasqyrave financiare është dhënia e informacionit kontabël mbi gjendjen financiare të firmës, në shërbim të palëve të interesuara. Sipas Lewis dhe Pendrill (2004), “objektivi i pasqyrave financiare është dhënia e informacioneve rreth pozicionit financiar, performancës financiare dhe ndryshimeve në pozicionin financiar të një entiteti, të cilat janë në interes për një game të gjerë përdoruesish në marrjen e vendimeve të tyre ekonomike.”<sup>17</sup> (Pendrill & Lewis, 2004) Aksionaret dhe menaxhmenti para se të gjithash kërkojnë të jenë të përditësuar me mënyrën e operimit të ndërmarrjes për ti dhënë përgjigje pyetjes se a është ndërmarrja në rrugën e duhur drejt realizimit të qëllimeve dhe objektivave, kreditorët janë të interesuar për likuiditetin e ndërmarrjes, ndërsa investitorët potencial domosdoshmërisht kërkojnë të analizojnë pasqyrat financiare përpara se të vendosin të investojnë paratë e tyre.

<sup>14</sup> Halit Xhafa, “Drejtimi Financiar”, Tiranë, 2012, fq. 86.

<sup>15</sup> Po aty, fq. 86.

<sup>16</sup> Po aty, fq. 87.

<sup>17</sup> Lewis Richard & Pendrill David, “Advanced Financial accounting”, edicioni I shtatë, 2004, fq. 76-95.

Megjithatë, përveç palëve të lartpërmendura, analiza e pasqyrave financiare shpesh herë mund kryhet edhe nga palë të treta të cilat jo domosdoshmërisht kanë interes të drejtpërdrejt mbi gjendjen apo performancën financiare të një subjekti të caktuar apo një grupe të caktuar të firmave.

Studimet e realizuara nga autorë të ndryshëm i janë qasur problemit të analizës së pasqyrave financiare dhe kështu performancës financiare nga motive dhe perspektiva të ndryshme, duke reflektuar njëherit jo vetëm një kontribut empirik dhe akademik, por gjithsesi edhe të vendimmarrjes menaxheriale. Për shembull, Ashor Kumar Rath, profesor i ekonomisë në “Trident College of Management”, Indi, në vitin 2016 ka publikuar studimin e tij me titull “Analiza e pasqyrave financiare për Tata Steel”. Pra, siç mund të kuptohet nga vetë titulli i studimit në fjalë, firma në studim është “Tata Steel Group”, një nga 10 prodhuesit më të mëdhenj të çelikut në botë. Duke qenë se ndërmarrja është në prag të zgjerimit të kapaciteteve të saja prodhuese, autori përpiket të ofrojë opsionin më të mirë financiar për të mbështetur projektin e zgjerimit. Ai gjithashtu kërkon që të nxjerr në pah pikat e forta dhe dobësitë e ndërmarrjes duke analizuar një gamë të gjerë të treguesve financiar.<sup>18</sup> (Rath, 2016)

Më tej, “Analiza e pasqyra financiare”, është një studim i Rohan Brown, i cili ka për qëllim të shqyrtojë dhe analizojë pasqyrat financiare të dy prej kompanive më të mëdha në industrinë e shitjes me pakicë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, “Walmart Stores Inc” dhe “Target Corporation”. Në këtë studim autori përmes treguesve financiar analizon performancën financiare dhe bën krahasime të dy kompanive të lartpërmendura duke shfrytëzuar të dhënat financiare për vitin 2006.<sup>19</sup> (Brown, 2006)

Këtu po ashtu mund të perëndimin edhe studimin e një autori tjetër, Dan Skorpnik, i cili ka analizuar pasqyrat financiare të kompanisë “Thermotemp SPOL. S.R.O”, një kompani çeke e cila kryesisht ofron shërbime hidraulike, instalime të sistemeve të ngrohjes dhe pajisjeve klimatike. Studimi i tij i titulluar, “Analiza financiare e kompanisë Thermotemp SPOL.S.R.O.”, kryesisht ofron një analizë të gjendjes financiare të ndërmarrjes për periudhën 2008-2014. Studimi mbështetet në analizën vertikale dhe horizontale, analizën e treguesve kryesor financiar, por autori gjithashtu ofron krahasime me konkurrentet dhe mesataren e industrisë dhe e pasuar më pas me konkluzione dhe sugjerime për të ardhmen.<sup>20</sup> (Skorpnik, 2016)

Një tjetër studim është realizuar nga Joakim Hannuksela, “Analiza e raporteve financiare të Supercell LTD”. Autori përmes këtij studimi ka për qëllim që të analizojë raportet kryesore financiare të entitetit në fjalë, pra “Supercell LTD”, duke u mbështetur kryesisht mbi profitabilitetin, solventitetin dhe likuiditetin.<sup>21</sup> (Hannuksela, 2018)

Padyshim që literatura dhe studimet e realizuara në këtë drejtim vinë duke u pasuruar nga viti në vit si rezultat i më shumë faktorëve të ndryshëm dhe manifestimi i tyre në performancën

---

<sup>18</sup>Ashok Kumar Rath, “A Study on Financial Statement Analysis of Tata Steel Odisha Project”, Kalinga Nagar, 2016.

<sup>19</sup>Rohan Brown, “Financial Statement Analysis”, Florida, USA, 2006.

<sup>20</sup>Dan Skorpnik, “Financial Analysis of a company Thermotemp, spol.s.r.o”, Brno, Czech Republic, 2016.

<sup>21</sup>Joakim Hannuksela, “Fiancial Ratio Analysis case Supercell LTD”, Talinë, 2018

financiare të biznesit, por edhe nga metodat e shumta dhe metodologjia hulumtuese e ndjekur nga autorë të ndryshëm.

Në këtë kuptim dhe frymë pretendon edhe ky studim masteri të jep një kontribut modest jo vetëm nga pikëpamja akademike por edhe menaxheriale, duke u motivuar dhe mbështetur kështu në studimet empirike, konceptet, qasjet dhe literaturën e gjerë të analizës së pasqyrave financiare në kontekstin e rastit studimor.

Nga shembujt që u cekën më sipër, por edhe analiza e performancës financiare për “Banjat e Dibrës Capa”, do të jetë kryekëput e fokusuar në pasqyrat financiare të firmës, të cilat tregojnë ecurinë afariste dhe financiare të entitetit kontabël.

Megjithatë, pa prekur akoma pasqyrat financiare, nga kërkimi empirik mund të themi se ndërmarrja në fjalë është në gjendje të konsolidueshme financiare, përdor kapacitet e saja investuese me qëllim të përmirësimit të shërbimeve dhe ka një ecuri pozitive në drejtim të zhvillimit të veprimtarisë së saj nga viti në vit.

Ky konstatim është i bazuar vetëm në studime dhe rezultate preliminare, kryesisht i siguar nga raportet të ndryshme të publikuara nga organizata të ndryshme që në mënyrë të drejtpërdrejtë prekin dhe na japin informacion mbi ndërmarrjen në fjalë. Kjo qasje në fakt është marrë me qëllim që rezultatet dhe konstatime përfundimtare të mund ti japim vetëm pas analizës së pasqyrave dhe treguesve real të ndërmarrjes, të cilat na janë ofruar nga vetë menaxhmenti i ndërmarrjes.

Kështu, për shembull, në raportin e fundit, atë të vitit 2017, për TOP 100 ndërmarrjet më të suksesshme me kapital shqiptar në Republikën e Maqedonisë Veriore, të publikuar nga “Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri-Perëndimore”, ndërmarrja “Banjat e Dibrës – Capa” radhitet mes 10 ndërmarrjeve, konkretisht e 8-ta në radhë, me më së shumti investime të realizuar gjatë vitit 2017. Shuma gjithsej e investimeve arrin në 804,462.88 euro.

<b>Nr.</b>	<b>Firma</b>	<b>Veprimtaria</b>	<b>Shuma</b>
<b>1.</b>	ZSF Kom	Ndërtimtari	3,572,560.29
<b>2.</b>	Bas Tuti Fruti	Prodhim të ambalazheve plastike	2,167,906.26
<b>3.</b>	Pofix	Prodhim të materialeve ndërtimore	1,752,459.28
<b>4.</b>	Ing Luli	Ndërtimtari	1,450,017.25
<b>5.</b>	Dauti Komerc	Distribuim	1,294.366.96
<b>6.</b>	Renova	Prodhim të materialeve ndërtimore	1,035,608.85
<b>7.</b>	Ilfa Tekstil	Industria e tekstit	959,346.60
<b>8.</b>	<b>Banjat e Dibrës CAPA</b>	<b>Rehabilitim fizik</b>	<b>804,462.88</b>
<b>9.</b>	AK Invest	Ndërtimtari	572,016.11
<b>10.</b>	Aldako	Distribuim	525,356.36

Tabela 1- Përpunim i autorit - 10 kompanitë në RVM me më së shumti investime në 2017

Burimi : Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri – Perëndimore, TOP 100, Shkup, 2018.



Në raportin e njëjtë, për sa u takon numrit të punësuarve, firma “Banjat e Dibrës Capa”, radhitet e 6-ta në mes 100 ndërmarrjeve të tjera, pasi numëron 157 të punësuar, duke shënuar një rritje prej 12.14% krahasuar me vitin paraprak, pra vitin 2016.

Një tjetër rangim që bëhet në raportin vjetor të “Odes Ekonomike të Maqedonisë Veri Perëndimore”, është klasifikimi i ndërmarrjeve në bazë të neto fitimit vjetor, në të cilin theksohet se ndërmarrja në fjalë ka realizuar fitim prej 593,365.25 euro, konkretisht ka shënuar rritje prej 37.84% krahasuar me vitin 2016.<sup>22</sup> (Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri - Perëndimore, 2018)

Këto të dhëna na japin perceptimin preliminar se ndërmarrja në fjalë i shfrytëzon kapacitetet e saja investuese me qëllim të përmirësimit të kushteve infrastrukturore dhe shërbimeve që ofron, dhe nga ana tjetër me qëllim të realizimit të rezultateve sa më të mira financiare. Megjithatë, na duhet një analizë e përgjithshme e indikatorëve – treguesve financiarë për të dhënë një verdikt përfundimtar në lidhje me efikasitetin e investimeve dhe kthimit të tyre në rezultatin financiar, gjë të cilën do ta shtjellojmë në kapitujt e ardhshëm.

---

<sup>22</sup> OEMVP, TOP 100 2018, Shkup, 2018.

## KREU III. TË DHËNAT DHE METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

### 3.1. Industria, burimet e të dhënave dhe përshkrimi i firmës

Turizmi paraqet veprimtari ekonomike mjaft me rëndësi për zhvillimin ekonomik të një vendi dhe në këtë rast edhe të RMV-së. Me ndihmën e turizmit realizohet dhe zmadhohet rritja ekonomike dhe zhvillimi i vendit, tërhiqen investimet e huaja, krijohen vendet e reja të punës dhe kështu përmirësohet standardi jetësor si rezultat i flukseve hyrëse të parasë në vend ose rajon. Gjithashtu, turizmi ndihmon edhe për stimulimin e industrisë lokale (zhvillimin e biznesit lokal) dhe tregtisë, për promovimin e vlerave kulturore dhe pasurive natyrore, për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe ngjashëm.<sup>23</sup>(macedonia-timeless.com, n.d.)

Në Republikën e Maqedonisë Veriore (RMV), ka potenciale për zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit, por për shkaqe objektive dhe subjektive, mund të themi se turizmi si veprimtari ekonomike ofron një kontribut modest në ekonominë e vendit. Sipas raportit të publikuar nga World Travel & Tourism Council, mbi ndikimin ekonomik të turizmit në Republikën e Maqedonisë Veriore për vitin 2017, kontributi i drejtpërdrejtë i turizmit në Bruto Prodhimin e Brendshëm është 11.2 miliardë denarë (\$206.3ml), pra 1.2% nga BPB-ja e përgjithshme në vitin 2017 (shih grafikun në vazhdim).<sup>24</sup>

#### MACEDONIA: DIRECT CONTRIBUTION OF TRAVEL & TOURISM TO GDP




Figura 2 - Maqedoni, kontributi direkt i turizmit në GDP

Burimi: WTTC, Travel & Tourism Economic Impact 2018 Macedonia.

<sup>23</sup>[https://macedonia-timeless.com/alb/rreth\\_nesh/rreth\\_nesh/turizmi-ne-maqedoni/](https://macedonia-timeless.com/alb/rreth_nesh/rreth_nesh/turizmi-ne-maqedoni/).

<sup>24</sup>WTTC, Travel & Tourism Economic Impact 2018 Macedonia, Mars 2018, fq. 1.

Po ashtu, sa i takon kontributit direkt në punësim, turizmi si sektor ekonomik ka ndikuar me 1.6% nga numri i përgjithshëm i punësimeve për vitin 2017. Në raportin e njëjtesqyrohetdhe kontributi i turizmit në investime, që për vitin 2017 është 5.5 miliardë denarë dhe paraqet 2.4% të investimeve gjithsej. Në krahasim me vendet e tjera të botës, nëse marrim në konsideratë indikatorët e lartpërmendur, Maqedonia Veriore radhitet në vendin e 148 në botë sa i takon kontributit të turizmit në BPB-së, në vendin e 152 për ndikimin e turizmit mbi punësimin dhe e 147-ta për sa i takon investimeve në turizëm.<sup>25</sup> ((WTTC), 2018) Megjithatë, nëse indikatorët e lartpërmendur i krahasojmë me vitet paraprahe, mund të themi se kemi një rritje të konsiderueshme.

Në vendin tonë kryesisht ka interes të veçantë për turizëm kulturor dhe fetar, aktiv dhe rural, gjithashtu interes ka në turizmin malor si dhe në vizitën e liqeneve natyrore, si liqeni i Ohrit, Dojranit dhe Prespës.<sup>26</sup> (macedonia-timeless.com, n.d.)



Figura 3 - Turizmi në Republikën e Maqedonisë Veriore – Liqeni i Ohrit

Burimi: [www.pixabay.com](http://www.pixabay.com)

Shkupi, si kryeqytet i vendit, është ndër qytetet më të vizituara në vend. Shkupi nuk zhgënjën për nga arkitektura urbane, dhe njëkohësisht ofron atraksione të shumta që tërheqin vëmendjen e turistëve. “Ura e Gurit” mbi lumin Vardar, “Kalaja e Shkupit”, “Sheshi Maqedonia” si dhe “Shtëpia përkujtimore e Nënë Terezës”, janë disa nga pikat kryesore turistike të qytetit. Një tjetër qytet turistik është qyteti historik i Ohrit, i cili ndodhet në jug – perëndim të vendit dhe laget nga ujërat e liqenit të Ohrit. Rajoni i Ohrit është i përfshirë në trashëgiminë botërore të UNESCO-s, dhe shquhet për plazhet e bukura rreth liqenit dhe numrin e lartë të kishave dhe manastireve. Si destinacione të rëndësishme turistike në vend janë edhe parqet nacionale,

<sup>25</sup>WTTC, Travel & Tourism Economic Impact 2018 Macedonia, Mars 2018, fq. 1.

<sup>26</sup>[https://macedonia-timeless.com/alb/rreth\\_nesh/rreth\\_nesh/turizmi-ne-maqedoni/](https://macedonia-timeless.com/alb/rreth_nesh/rreth_nesh/turizmi-ne-maqedoni/).

veçanërisht “Parku Nacional i Mavrovës”, i preferuar kryesisht për alpinizëm, ndërsa gjatë stinorit dimëror është i populluar me turistë që shfrytëzojnë resortet e shumta të skijimit. Pra në përgjithësi, Maqedonia turistike karakterizohet me qytete historike, me kulte të shumta fetare, male të larta që shtrihen pothuajse përgjatë gjithë territorit të vendit, kanione të bukura dhe liqene piktoreske.

Ekspertët e turizmit vlerësojnë se Maqedonisë Veriore, për shkak se nuk ka dalje në det, që konsiderohet si një pikat kyçe për zhvillimin e turizmit masiv, duhet që të orientojë mekanizmat dhe kapacitetet e saja drejt llojeve të tjera të turizmit, të shfrytëzojë më mirë potencialet që zotëron si dhe të hartojë strategji afatgjate për zhvillimin e turizmit. Sipas Kohl & Partner, 8 janë pikat kyçe mbi të cilat Maqedonia Veriore duhet të hartojë strategjinë e saj mbi zhvillimin e turizmit:<sup>27</sup>(Kohl & Partner, 2016)

- Promovimi i Maqedonisë si një destinacion turistik jashtë vendit,
- Përmirësimi i atraktivitetit të Maqedonisë si destinacion turistik,
- Zhvillimi i strukturave organizacionale në turizëm,
- Përmirësimi i klimës së investimeve për sipërmarrësit me qëllim të zhvillimit të kushteve moderne akomoduese,
- Përmirësimi në sasi dhe cilësi të dhënave turistike,
- Përmirësim të strukturës së mjedisit rrethues me qëllim të zhvillimit të turizmit,
- Ngritje e vetëdijes mbi turizmin dhe përmirësimin e shërbimeve dhe
- Promovim më i mirë i vlerave turistike në popullatën lokale.

### **Turizmi kurativ dhe banjat termale në Republikën e Maqedonisë Veriore**

Ndër lëvizjet turistike, në vendin tonë ka mundësi dhe potencial të madh për zhvillim të turizmit kurativ. Këtu posaçërisht të frekuentuara janë burimet termo minerale, me veti kurative për shumë sëmundje. Ky lloj turizmi ka të bëjë me lëvizjen e një kategorie njerëzish drejt tyre për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit. Turizmin termal (banjat) mund ta përkufizojmë si vizitë dhe qëndrim në qendra të specializuara të cilat ofrojnë mundësi për relaksim dhe shërim të sëmundjeve të ndryshme përmes shfrytëzimit të ujërave shëruese termo minerale. Në shumë fjalorë banjat janë të definuar si burime minerale apo vende në të cilat është gjetur burim mineral. Banjat mund ti definojmë si vende të cilat janë të përkushtuara drejt rritjes dhe përmirësimit të cilësisë së jetës përmes shërbimeve të ndryshme profesionale të cilat ndihmojnë në rikuperimin e shëndetit fizik, mendor dhe shpirtëror.<sup>28</sup> (Tashkov & Metodijeski, 2014)

Republika e Maqedonisë Veriore është e pasur me burime të shumta gjeo termale të cilat ofrojnë mundësinë e zhvillimit të biznesit me hapjen e SPA qendrave kurative. Megjithatë, vendin tonë numërojmë vetëm 8 banja termo minerale të cilat shërbejnë si qendra kurative dhe turistike. Banjat ekzistuese janë ndërtuar gjatë periudhës mes viteve 1960 dhe 1980. Më pas ka

<sup>27</sup> Kohl & Partner, “National Tourism Strategy, Republic of Macedonia”, Shkup, 2016, fq. 85.

<sup>28</sup> Tashkov Nako., Metodijeski Dejan, “Turizmi Termal”, UGD – Shtip, 2014, fq. 12.

vijuar procesi i stagnimit si rezultat i përshtatshmërisë graduale si dhe procesit të privatizimit. Banjat termale janë të përfshira në politikën e përkujdesit shëndetësor të vendit, të drejtuara dhe të financuara nga ana e fondit shëndetësor përmes kontributeve shëndetësore.<sup>29</sup> (mn.mk.com)

Pas procesit të privatizimit, në shumicën prej këtyre banjave termale janë marrë iniciativa dhe është investuar me qëllim të përmirësimit infrastrukturor të godinave si dhe ofrimin e shërbime moderne kurative. Shumica e vizitorëve janë vetë shtetas të vendit ndërsa kohëve të fundit është gjithnjë e në rritje numri i vizitorëve nga vendet fqinje. Pavarësisht trendëve botërore, në vendin tonë banjat termale më së tepërmi shfrytëzohen për shërbime kurative, pra njerëz që vijnë të kurohen nga lloje të ndryshme të sëmundjeve, dhe gjithnjë e më pak përdoren për rekreacion dhe vetë – kënaqësi.

Në vijim do të njihemi shkurtimisht me disa nga banjat kryesore dhe më të mëdha në vendin tonë, ndërsa më pas do të ndalemi më gjerësisht te ndërmarrja që kemi për studim në këtë punim, pra “Banjat e Dibrës Capa – Dibër”.



Figura 4 - Banjat Termale në vendin tonë

Burimi: Kohl & Partner, “National Tourism Strategy, Republic of Macedonia”, Shkup, 2016.

- **Banja BANSKO** ndodhet në jug – lindje të vendit, në afërsi të qytetit të Strumicës dhe fshatit BANSKO. Ujërat e saj janë shëruese për disa sëmundje, por mbi të gjitha për sëmundjet reumatike. Kjo qendër kurative është e vendosur në hotelin “Car Samuili” dhe disponon me hapësira të ndryshme për terapi dhe rehabilitim mjekësor, si dhe hapësira të tjera të karakterit rekreativ dhe argëtues.<sup>30</sup> (mk.wikipedia.org)
- **Banjat NEGORCI** konsiderohen si qendër moderne turistike dhe shëndetësore e specializuar në trajtimin e sëmundjeve fizioterapeutike. Kompleksi ndodhet 3 km larg

<sup>29</sup><http://www.mn.mk/kultura/3905>.

<sup>30</sup>[https://mk.wikipedia.org/wiki/%D0%91%D0%B0%D1%9A%D0%B0\\_%D0%91%D0%B0%D0%BD%D1%81%D0%BA%D0%BE](https://mk.wikipedia.org/wiki/%D0%91%D0%B0%D1%9A%D0%B0_%D0%91%D0%B0%D0%BD%D1%81%D0%BA%D0%BE).

nga qyteti i Gjevgjeli, në lartësi mbidetare prej 50 metra. Sa u përket kapaciteteve akomoduese, këtu ndodhen hotelet “Bozhur”, “Jasen” dhe “Ilinden”, të trija nën kategorinë “B”, dhe posedojnë gjithsej 336 shtretër. Mes të tjerave, në këtë kompleks gjenden 2 basene termale të mbyllura dhe disa të tjera të hapura.<sup>31</sup> Këto banja janë nën menaxhimin e kompanisë “ZUPL Banjat Negorci”. (mk.wikipedia.org)

- **Banja Kezhovica** ose siç njihet ndryshe si banja e Shtip-it, është një tjetër SPA qendër e cila ndodhet rreth 2 km në jug – perëndim të qytetit të Shtip-it. Kjo banjë daton që nga koha e perandorisë osmane, dhe kryesisht është shfrytëzuar për higjienën personale dhe qëllime shëndetësore. Sot ky lokalitet posedon me basene të rregulluara dhe qendër për rehabilitim.<sup>32</sup>
- **Banjat e Katlanovës** është një tjetër SPA qendër moderne e cila disponon me disa basene termominerale dhe ofron shërbime të ndryshme fizioterapeutike dhe kozmetike. Ky kompleks ndodhet mbi fshatin Katlanovë, në lartësi mbidetare prej 230 m. Nga qyteti i Shkupit është i larguar 25 km. Hoteli i parë në këtë kompleks është ndërtuar në vitin 1943, ndërsa sot ka 3 hotele dhe disa pushimore, me kapacitet të përgjithshëm prej 450 shtretër. Në vit banjat e Katlanovës numërojnë rreth 10,000 vizitorë.<sup>33</sup>



Figura 5- Trajtime Kurative në Banjat e Katlanovës

Burimi: [www.katlanovskaspa.com](http://www.katlanovskaspa.com).

<sup>31</sup> [https://mk.wikipedia.org/wiki/Негорски\\_бањи](https://mk.wikipedia.org/wiki/Негорски_бањи).

<sup>32</sup> <https://mk.wikipedia.org/wiki/%D0%9A%D0%B5%D0%B6%D0%BE%D0%B2%D0%B8%D1%86%D0%B0>.

<sup>33</sup> [https://mk.wikipedia.org/wiki/Катлановска\\_Бања](https://mk.wikipedia.org/wiki/Катлановска_Бања).

## **Historiku dhe veprimtaria e ndërmarrjes “Banjat e Dibrës - Capa”**

Qyteti i Dibrës karakterizohet me pasuri të shumta natyrore dhe kushte mjaft të volitshme për zhvillimin e turizmit dhe zhvillimin e përgjithshëm të ekonomisë. Megjithatë, periudha e tranzicionit, menaxhimi jo i mirë i procesit të privatizimit, emigracioni dhe faktorë të tjerë të ndryshëm, kanë ndikuar që Dibra, njëjtë si pjesa dërmuese e vendit të çalon në zhvillimin ekonomik.

Në Dibër kryesisht mbizotëron biznesi i vogël, tregtia, ndërsa një pjesë e vogël e popullatës merren me kultura bujqësore. Edhe turizmi, si veprimtari ekonomik, pavarësisht liqenit piktoresk dhe kanionit të lumit Radika, është shumë pak i zhvilluar. Megjithatë, një impuls të veçantë turizmit në Dibër i japin ujërat termo minerale, konkretisht banjat kurative. Burimet termo minerale gjenden në dy lokacione të ndryshme në Dibër, edhe atë në fshatin Kosovrast dhe Banjisht, në të cilat janë ngritur edhe komplekset banjore kurative, dhe të cilat sot janë në pronësi dhe menaxhim të firmës që kemi për objekt studimi, pra “Banjat e Dibrës Capa”.

Të dhënat e para të shkruara për ekzistimin e banjave termale në fshatin Banjisht datojnë nga shekulli i XVIII, ku në njërin nga gurët themelet e baseneve në gjuhën arabe është gdhendur viti i themelimit, 1797. Basenet e para janë themeluar nga Haxhi Muxhedin, anëtar i familjes së vjetër dibrane Uruçi Zade. Pra, basenet e para me ujëra termo minerale janë ndërtuar gjatë periudhës së sundimit otoman në Ballkan.<sup>34</sup> (bdcapa.com, n.d.)

Banjat e Dibrës janë themeluar më 21.04.1948, si qendra banjore kurative më e mirë në ish Jugosllavinë, dyert e së cilës kanë qenë të hapura për funksionarë të lartë shtetëror aso kohe dhe klasën e lartë shoqërore. Gjatë gjithë kësaj periudhe banjat e Dibrës kanë qenë nën pronësinë e pushtetit vendor, ndërsa më 15 Tetor 2004, u privatizua pasi familja Capa i bleu aksionet e shoqërisë në bursë. Duke patur parasysh gjendjen e rrënuar të godinave në Banjisht dhe Kosovrast, menjëherë pas privatizimit pronarët e rinj filluan punën për përmirësimin dhe modernizimit të komplekseve. Siç përshkruhet edhe në faqen zyrtare të shoqërisë, investimet arritën kulmin në vitin 2012, ku shuma e investuar kalon mbi 1 milion euro për renovimin e 72 dhomave në hotelin në Banjisht, 48 dhoma në kompleksin në Kosovrast, 14 dhoma në hotelin Venec si dhe renovimin e të gjithë hapësirave ku ofrohen shërbimet mjekësorë.<sup>35</sup>

Si subjekt ekonomik, “Banjat e Dibrës Capa” është shoqëri aksionare e regjistruar në regjistrin qendror në Shkup nga viti 2005. Veprimtaria bazë e firmës sipas vendimit të entit statistikor shtetëror numër 27-90250/3 i datës 16.02.1998 është 85.14/1 – Rehabilitimi mjekësor në institucione. Pra, thënë ndryshe ofrimi i turizmit banjar dhe rehabilitim trupor duke shfrytëzuar ujërat termo minerale. Selia e firmës është në rrugën “8 Shtatori” me numër 9 në Dibër.

<sup>34</sup><http://bdcapa.com/mk/%d0%b8%d1%81%d1%82%d0%be%d1%80%d0%b8%d1%98%d0%b0/>.

<sup>35</sup>Po aty.

Banjat e Dibrës Capa paraqesin një faktor të rëndësishëm ekonomik në qytet. Sipas të dhënave të vitit 2017, në këtë subjekt janë të punësuar 157 persona, të cilët kryesisht janë nga qyteti i Dibrës dhe rrethina, ndërsa rreth 20 persona të tjerë punësohen me kontratë të përkohshme çdo vit gjatë stinorit veror.

Nga menaxhmenti i firmës në fjalë mësojmë se me privatizimin dhe investimet që kanë pasuar me qëllim të përmirësimit të qendrave kurative dhe shërbimeve, është shënuar një rritje e konsiderueshme e numrit të klientëve, e cila rrjedhimisht ndikon edhe në të hyrat e ndërmarrjes. Investimet kanë mundësuar zhvillimin e turizmit kurativ me standarde evropiane. Ndërhyrjet për përmirësimin e kushteve dhe shërbimeve përfshijnë:

- modernizimi i strukturave hotelerie pritëse,
- ndërtimi i pishinave të reja,
- restaurimi i dhomave dhe ambienteve pritëse,
- investime në pajisje moderne mjekësore
- investime në zëvendësimin e energjisë elektrike me energjinë e ujit termal mineral kombinuar me atë solar.



Figura 6- Investimet dhe modernizimi i strukturave hoteliere në Banjat e Dibrës Capa

Burimi: Uebfaqja e firmës “Banjat e Dibrës Capa, [www.bdcapa.com](http://www.bdcapa.com).

Krahas investimeve dhe ndërhyrjeve të lartpërmendura, drejtuesit e Banjave të Dibrës Capa kanë ndërmarrë edhe ndërhyrje strategjike, të cilat konsistojnë në intensifikimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me pushtetin vendor dhe atë lokal, si dhe me ente dhe shoqata të ndryshme.



Më tej, për të pasur një ide mbi kënaqësinë e klientit mbi shërbimet e ofruara, është realizuar një anketë të thjeshtë me klientët të cilët rastësisht i kemi hasur në ambientet e hoteleve Banjisht dhe Kosovrast. Anketa është realizuar në tetor të vitit 2019 ku janë pyetur 42 klientë të rastësishëm, kryesisht të moshës mbi 40 vjeçare. Qëllimi kryesor i anketimit ishte që mësojmë nga konsumatorët sesa janë të kënaqur me shërbimet e ofruara, gjë e cila padyshim reflektohet në performancën e biznesit. Nga opsionet e parashtruara, ku “shumë i/e kënaqur” konsiderohet si vlerësimi më i lartë dhe “aspak i/e kënaqur” konsiderohet si vlerësimi më i ulët, na rezultojnë këto rezultate:




Figura 7 - Përpunim i autorit, Anketë në lidhje me kënaqësinë e klientit

Siç tregohet pyetëtori ngërthen komponentin e shërbimit dhe stafit mjekësor, kurat termale, ushqimin e ofruar, akomodimin dhe nivelin e çmimit (këtu disa klientë nuk janë përgjigjur). Përkundër rezultateve të arritura do të ishte mirë në të ardhmen që pyetësori të tillë, mbase më të avancuar, të përsëriten me qëllim marrjen e mendimit të klientëve dhe kështu të përmirësohet dhe avancohet vazhdimisht performanca e biznesit.

### 3.2. Pyetjet dhe hipotezat e hulumtimit

Në këtë studim do të synojmë që të ofrojmë një analizë dhe vlerësim konkret të performancës financiare të ndërmarrjes “Banjat e Dibrës – Capa”, për periudhën 2007-2017. Konkretisht, pyetjet kërkimore dhe hipotezat e ngritura në këtë studim reflektojnë nëse gjendja financiare e biznesit është përmirësuar apo përkeqësuar gjatë periudhës të marrë në shqyrtim.

Nëpërmjet analizës së raporteve financiare dhe matjes së indikatorëve kryesor financiar, do të përpiqemi që të japin përgjigje në pyetjet e mëposhtme për biznesin në fjalë dhe periudhën e analizës:

- *Cila është performanca financiare aktuale e biznesit?*
- *Cili është niveli i likuiditetit aktual të biznesit?*
- *A është ndërmarrja profitabile dhe cili është trendi në të ardhmen?*
- *A ekziston një lidhje në mes profitabilitetit dhe likuiditetit të biznesit?*

Bazuar në objektivin bazë të studimit (analiza e performancës financiare) dhe pyetjet kërkimore të prezantuara më lartë janë hartuar hipotezat të cilat udhëheqin dhe hapin rrugën për vazhdimin e studimit. Sigurisht që në mes këtyre tre komponentëve ka një lidhje mbi të gjitha logjike dhe funksionale: objektive – pyetje hulumtuese – hipotezë.

Atëherë, duke patur parasysh se biznesi në fjalë viteve të fundit ka realizuar investime afatgjatë në infrastrukturë dhe përmirësim të kushteve të klientëve, rëndom aksionarët dhe menaxhmenti do të presin që edhe performanca financiare e ndërmarrjes të jetë përmirësuar për të argumentuar dhe justifikuar paranë e investuar. Prandaj, janë parashtruar dy hipoteza:

***H1 – Performanca e firmës “Banjat e Dibrës-Capa” është përmirësuar si rezultat i investimeve në infrastrukturë.***

***H2 – Raporti risk dhe kthim nga investimet në infrastrukturë është në harmoni me pritshmërinë e vendimmarrësve menaxherial dhe aksionarëve.***

### 3.3. Metodologjia e hulumtimit

Ky punim i masterit fillon nga e përgjithshmja, pra çfarë është bërë më herët apo nga pikëpamja teorike/empirike që më pastaj të vazhdon me rastin studimor për periudhën e përzgjedhur të analizës dhe duke ndjekur kryesisht hapat si në vijim:

- Shqyrtimi i literaturës nga autorë të vendit dhe të huaj që lidhen me çështjet teorike të studimit (konceptet dhe metodat teorike);

- Vëzhgim i përgjithshëm i të dhënave kontabël të firmës por edhe ambientit të jashtëm /sektorit;
- Shfrytëzimi i të dhënave primare të gjendjes dhe performancës financiare të firmës gjatë viteve 2007-2017;
- Analiza e treguesve financiare, vertikale, horizontale dhe analiza e trendit;
- Krahasimi kuantitativ i të dhënave dhe rezultateve;
- Trajtimet statistikore dhe ato grafike;
- Vëzhgimi i drejtpërdrejt në terren;
- Nxjerrja e përfundimeve dhe rekomandimeve për përmirësime të mundshme, etj.

Metodat që përdoren në këtë punim masteri janë metoda statistikore dhe të analizës financiare (pra sasiore), por shfrytëzohen edhe metodat e analizës kualitative (pjesa e pyetësorit/intervista – diskutimet).

Të dhënat primare të gjendjes dhe performancës financiare të firmës gjatë viteve 2007 – 2017 do të merën si referencë dhe do të shërbejnë si pikënisje e studimit të rastit studimor. Këto të dhëna nuk janë përdorur më herët në një studim si ky punim masteri, andaj paraqesin të dhëna bazë dhe primare në funksion të argumentimit apo mos argumentimit të rezultateve.

Të dhënat kontabël do të përdoren për të llogaritur treguesit financiarë, për të realizuar analizën vertikale, horizontale, apo të tendencës (parashikimi financiar për tregues të caktuar financiarë) dhe përdoret metoda krahasuese e cila nënkupton krahasimin e rezultateve me periudhën paraprake, me një normë ose me tregues tjetër të ngjashëm në kontekst të problemit konkret.

Në rastin konkret do të krahasohen raportet financiare të firmës për të parë sesi ka ndryshuar apo evoluar performanca financiare e firmës gjatë kësaj periudhe, para dhe pas investimit, apo me normat-standardet e njohura, bie fjala, rregulli i gishtit të madh dhe për të dhënë sugjerimet e mundshme në funksion të përmirësimit të së njëjtës në të ardhmen.

## KREU IV. ANALIZA DHE DISKUTIMI I REZULTATEVE

Pasqyrat financiare ofrojnë një pamje të qartë dhe precize të gjendjes dhe performancës financiare të një subjekti të caktuar. Sot është e paimagjinueshme mbarëvajtja dhe ecuria e një biznesi pa analizë të vazhdueshme të të dhënave financiare. Analiza e pasqyrave financiare jo vetëm që i shërben menaxhmentit të ndërmarrjes për të korigjuar devijimet e mundshme, por gjithashtu paraqet edhe si pikë referimi në vendimmarrje për të gjithë palët e tjera me interes në një biznes të caktuar. Me fjalë të tjera, mund të themi se analiza e të dhënave financiare konsiderohet si metodë kuantitative/kualitative për të definuar të kaluarën, të tashmen dhe për të përcaktuar performancën prospektive financiare të ndërmarrjes.

Kreu në fjalë kryekëput konsiston në analizën e të dhënave financiare të ndërmarrjes në studim, “Banjat e Dibrës Capa”. Të dhënat e paraqitura tregojnë më së miri ecurinë financiare të firmës përgjatë periudhës të marrë për studim. Të dhënat dhe informacioni është i siguar nga vetë menaxhmenti i firmës me qëllimin e vetëm për ti shërbyer këtij studimi.

Në fillim do të paraqesim bilancin e gjendjes dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve apo siç njihet ndryshe bilanci i suksesit për periudhën 2007-2017, me qëllim për ti ofruar lexuesit një ide të përgjithshme mbi gjendjen financiare të firmës. Në vijimësi, do të realizojmë analizën horizontale dhe vertikale.

Pas analizës horizontale dhe vertikale, do të ofrojmë analizën e trendit dhe më pas përlllogaritjen e treguesve kryesor financiarë, e gjithë kjo e mbështetur me komente që pasojnë rezultatet. Mirëpo fillimisht, le të njihemi me pasqyrat financiare të ndërmarrjes, edhe atë bilancin e gjendjes dhe bilancin e suksesit, për periudhën e marrë në shqyrtim, nga viti 2007 deri në vitin 2017.

### 4.1. Analiza horizontale

Analiza horizontale është një nga teknikat kryesore të analizës së pasqyrave financiare e cila konsiston në krahasim e të dhënave financiare për dy ose më shumë viteve. Analiza horizontale bazohet në prirjen e llogarive të shprehura si në njësi monetare ashtu edhe në përqindje. Ajo u ofron analistëve një pasqyrë të qartë të ecurisë dhe performancës financiare të ndërmarrjes për një numër të caktuar të viteve, vërehen uljet apo ngritjet për çdonjërin nga zërat e paraqitura nga viti në vit, dhe mbi të gjitha të u mundëson analistëve të përcaktojnë nëse ndërmarrja performon me efikasitet dhe a është profitabile.<sup>36</sup> (Investopedia.com, n.d.)

Në tabelat në vijim do të paraqesim ndryshimet nga viti në vit si për bilancin e gjendjes ashtu edhe bilancin e suksesit, nga viti 2007 deri në vitin 2017. Ndryshimet paraqiten si në vlerë monetare, pra në denarë, ashtu edhe në përqindje. Ndryshimi në vlerë monetare përlllogaritet në atë mënyrë që nga viti aktual zbritet shuma e vitit paraprak. Ndërkaq, për të llogaritur dallimin në përqindje vlera numerike e ndryshimit pjesëtohet me shumën e vitit paraprak dhe rezultati

<sup>36</sup><https://www.investopedia.com/terms/h/horizontalanalysis.asp>.

shumëzohet me 100. Tabelat 4, 5, 6, dhe 7 u referohen zërave të bilancit të gjendjes, ndërsa tabelat 8, 9, 10 dhe 11 paraqesin ndryshimet në bilancin e suksesit.

Nga të dhënat e paraqitura në tabelat e mëposhtme, si në analizën horizontale në bilancin e suksesit ashtu edhe në bilanc të gjendjes mund të vërehet se performanca financiare e ndërmarrjes nga viti 2007 deri në vitin 2017 është përmirësuar ndjeshëm. Siç mund të vërehet nga tabela 8, fitimi neto pas tatimit në vitin 2007 është 884,832 denarë, ndërsa në vitin 2017 shënon 36,508,568 denarë, tabela 11. Megjithatë, trendi nuk ka qenë vazhdimisht progresiv, për shembull në vitin 2008 kemi rënie të fitimit neto në krahasim me vitin 2007, tabela 8. Po ashtu rënie të fitimit neto shënohet edhe në vitet 2011 dhe 2013 krahasuar me vitet paraprake, tabela 9, si dhe në vitin 2014, tabela 10.

<b>AKTIVA</b>	<b>2007</b>	<b>2008</b>	<b>2009</b>	<b>2010</b>	<b>2011</b>	<b>2012</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>	<b>2017</b>
<b>Aktivitet fikse</b>	<b>148,244,838</b>	<b>157,984,358</b>	<b>145,260,278</b>	<b>145,216,615</b>	<b>144,529,332</b>	<b>194,648,022</b>	<b>195,168,275</b>	<b>208,966,144</b>	<b>210,286,005</b>	<b>237,839,748</b>	<b>287,314,215</b>
Mjete jo materiale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Mjete materiale	138,114,324	142,081,920	136,585,476	144,621,613	143,934,330	194,053,020	194,573,273	208,371,142	209,691,003	237,244,746	286,719,213
Mjete fin. afatgjata	10,130,514	15,902,438	8,674,802	595,002	595,002	595,002	595,002	595,002	595,002	595,002	595,002
Kërkesa afatgjata										0	0
<b>Aktivitet afatshkurtra</b>	<b>27,483,217</b>	<b>26,185,571</b>	<b>25,783,334</b>	<b>28,281,201</b>	<b>51,714,448</b>	<b>34,861,699</b>	<b>47,336,963</b>	<b>23,646,054</b>	<b>26,984,386</b>	<b>71,809,999</b>	<b>42,512,465</b>
Inventarë	6,023,887	9,164,618	4,621,752	5,135,679	2,635,743	5,592,134	5,540,173	5,559,372	155,247	249,091	3,318,911
Kërkesa afatshkurtra	20,134,313	16,329,245	18,821,062	22,434,806	29,430,079	28,119,006	39,337,497	12,909,135	24,368,576	11,563,982	13,421,939
Mjete fin. afatshkurtra	0	0	0	0	0	0	0	0	0	12,669,029	20,488,282
Mjete në para dhe ek.t.p	1,325,017	691,708	2,340,520	710,716	19,648,626	1,150,559	2,459,293	5,177,547	2,460,563	47,327,897	5,283,333
<b>AKTIVA GJITHSEJ</b>	<b>175,728,055</b>	<b>184,169,929</b>	<b>171,043,612</b>	<b>173,497,816</b>	<b>196,243,780</b>	<b>229,509,721</b>	<b>242,505,238</b>	<b>232,612,198</b>	<b>237,270,391</b>	<b>309,649,747</b>	<b>329,826,680</b>
<b>PASIVA</b>	<b>2007</b>	<b>2008</b>	<b>2009</b>	<b>2010</b>	<b>2011</b>	<b>2012</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>	<b>2017</b>
<b>Kapitali dhe rezervat</b>	<b>98,300,809</b>	<b>98,302,840</b>	<b>99,358,859</b>	<b>107,197,292</b>	<b>107,631,699</b>	<b>122,973,370</b>	<b>137,498,199</b>	<b>151,161,849</b>	<b>161,264,903</b>	<b>185,861,948</b>	<b>219,220,516</b>
Kapital i regjistruar	96,904,123	96,904,123	96,904,123	65,241,400	65,241,400	65,241,400	65,241,400	65,241,400	65,241,400	65,241,400	65,241,400
Rezerva				31,662,723	31,662,723	31,662,724	31,662,724	46,195,553	59,245,303	67,488,499	90,825,544
Fitim i akumuluar	511,854	1,245,244	1,398,717	2,454,736	10,293,169	10,727,576	26,061,246	26,061,246	26,645,004	26,645,004	26,645,004
Humbja e bartur	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Fitimi për vitin financiar	884,832	153,473	1,056,019	7,838,433	434,407	15,333,670	14,532,829	13,663,650	10,133,196	26,487,045	36,508,568
Humbja për vitin fin.	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Detyrime</b>	<b>71,427,246</b>	<b>85,867,089</b>	<b>71,684,753</b>	<b>66,300,524</b>	<b>88,612,081</b>	<b>106,544,351</b>	<b>105,007,039</b>	<b>81,480,349</b>	<b>76,005,488</b>	<b>123,787,799</b>	<b>110,606,164</b>
Detyrime afatgjata	60,325,898	73,070,569	63,778,234	59,230,079	34,594,488	62,375,539	30,047,621	22,382,530	12,999,850	69,424,586	49,030,884
Detyrime afatshkurtra	17,101,348	12,796,520	7,906,519	7,070,445	54,017,593	44,168,812	74,959,418	59,097,819	63,005,638	54,363,213	61,575,280
<b>PASIVA GJITHSEJ</b>	<b>175,728,055</b>	<b>184,169,929</b>	<b>171,043,612</b>	<b>173,497,816</b>	<b>196,243,780</b>	<b>229,517,721</b>	<b>242,505,238</b>	<b>232,642,198</b>	<b>237,270,391</b>	<b>309,649,747</b>	<b>329,826,680</b>

Tabela 2- Përpunim i autorit - Bilanci i gjendjes për periudhën 2007-2017, Banjat e Dibrës Capa

Burimi: Banjat e Dibrës Capa

	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
<b>Të hyra nga veprimtaria bazë</b>	<b>76,565,135</b>	<b>83,600,195</b>	<b>94,577,183</b>	<b>101,029,641</b>	<b>106,768,128</b>	<b>120,835,749</b>	<b>124,407,646</b>	<b>134,176,716</b>	<b>138,517,498</b>	<b>154,724,256</b>	<b>175,089,271</b>
Të hyrja nga shitja	76,324,116	83,600,195	87,464,294	100,906,601	106,644,661	120,814,255	124,184,855	131,777,940	138,026,876	154,189,302	174,669,025
Të hyra të tjera	241,019	0	7,112,889	123,040	123,467	21,494	222,791	2,398,776	490,622	534,954	420,246
<b>Të dala nga veprimtaria bazë</b>	<b>75,593,761</b>	<b>83,395,814</b>	<b>87,131,094</b>	<b>88,180,339</b>	<b>99,771,451</b>	<b>100,760,605</b>	<b>104,292,347</b>	<b>108,036,788</b>	<b>123,946,126</b>	<b>122,472,929</b>	<b>131,994,916</b>
Shpenzime për lëndë të para	28,925,187	30,804,641	37,688,588	39,349,484	47,659,276	43,333,907	43,452,264	41,849,144	52,195,353	47,655,320	50,164,835
Kosto e mallit të shitur	1,356,014	1,202,009	1,035,718	972,084	1,719,714	1,461,862	1,618,168	1,736,349	2,465,900	2,869,180	3,557,104
Shërbime për shpenzime materiale	0	0	0	0	3,049,731	3,126,664	5,498,169	2,933,876	3,485,652	2,534,249	5,017,167
Shpenzime të tjera	0	0	0	0	4,216,679	5,628,242	5,699,109	4,656,193	13,559,047	323,771	15,200,585
Shpenzime për punëtorë	19,152,337	22,648,396	30,840,778	31,543,749	35,501,919	39,314,355	36,846,853	46,321,484	41,260,234	44,194,283	47,280,116
Amortizimi i mjeteve	0	0	7,289,875	6,806,206	7,403,861	7,895,575	10,330,380	10,361,463	10,787,820	10,245,905	10,126,171
Të dala tjera nga veprimtaria	26,160,223	28,740,768	10,276,135	9,508,816	220,271	0	847,404	178,279	192,120	14,650,221	648,938
<b>Të hyra financiare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>3,208</b>	<b>92,752</b>	<b>194,648</b>	<b>200,130</b>	<b>126,992</b>	<b>320,224</b>	<b>7,523</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Të dala financiare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>6,370,066</b>	<b>5,070,951</b>	<b>6,657,902</b>	<b>4,786,578</b>	<b>5,581,235</b>	<b>11,351,817</b>	<b>3,545,287</b>	<b>2,623,349</b>	<b>3,926,589</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>971,374</b>	<b>204,381</b>	<b>1,079,231</b>	<b>7,871,103</b>	<b>533,423</b>	<b>15,488,696</b>	<b>14,661,056</b>	<b>15,108,335</b>	<b>11,033,608</b>	<b>29,627,978</b>	<b>39,167,766</b>
2016	122,472,929	47,655,320	2,869,180	2,534,249	323,771	44,194,283	10,245,905	14,650,221	2,623,349
2017	131,994,916	50,164,835	3,557,104	5,017,167	15,200,585	47,280,116	10,126,171	648,938	3,926,589

Tabela 20- Përpunim i autorit, Struktura e shpenzimeve, 2007 – 2017




Figura 15- Përpunim i autorit, Struktura e shpenzimeve, 2007 – 2017

Në vazhdim, konsiderohet e arsyeshme që të paraqesim raportin e shpenzimeve, të hyrave dhe fitimit neto kundrejt numrit të të punësuarve, dhe të analizojmë të hyrat, shpenzimet dhe fitimin neto në përpjesëtim me numrin e punëtorëve nga viti në vit. Rezultatet i paraqesim në tabelën në vijim.

Viti	Të hyra nga veprimtaria bazë	Të dala nga veprimtaria bazë	Fitimi neto për vitin financiar	Numri i punëtorëve	Të hyrat/Nr. i punëtorëve	Të dalat/Nr. i punëtorëve	Fitimi neto/ Nr. i punëtorëve
2007	76,565,135.00	75,593,761.00	884,832.00	116	660,044.27	651,670.35	7,627.86
2008	83,600,195.00	83,395,814.00	153,473.00	120	696,668.29	694,965.12	1,278.94
2009	94,577,183.00	87,131,094.00	1,056,019.00	119	794,766.24	732,194.07	8,874.11
2010	101,029,641.00	88,180,339.00	7,838,433.00	122	828,111.81	722,789.66	64,249.45
2011	106,768,128.00	99,771,451.00	434,407.00	124	861,033.29	804,608.48	3,503.28
2012	120,835,749.00	100,760,605.00	15,333,670.00	125	966,685.99	806,084.84	122,669.36
2013	124,407,646.00	104,292,347.00	14,532,829.00	130	956,981.89	802,248.82	111,790.99
2014	134,176,716.00	108,036,788.00	13,633,650.00	129	1,040,129.58	837,494.48	105,687.21
2015	138,517,498.00	123,946,126.00	10,133,196.00	132	1,049,374.98	938,985.80	76,766.64
2016	154,724,256.00	122,472,929.00	26,487,045.00	140	1,105,173.26	874,806.64	189,193.18
2017	175,089,271.00	131,994,916.00	36,508,568.00	157	1,115,218.29	840,731.95	232,538.65

Tabela 21 - Përpunim i autorit, Të hyrat, shpenzimet dhe fitimi neto kundrejt numrit të punëtorëve




Figura 16 - Përpunim i autorit, Të hyrat, të dalat dhe fitimi neto kundrejt numrit të punëtorëve

Nga tabela e mësipërme dhe paraqitja grafike e të dhënave, mund të konstatojmë se sa janë të hyrat, të dalat dhe fitimi neto i firmës për një njësi punëtor. Numri i punëtorëve nga viti në vit është në rritje e sipërm, dhe nga linja e trendit mund të konstatojmë se performanca financiare e firmës e arsyeton rritjen në personel. Një aspekt tjetër me rëndësi dhe pozitiv për firmën është fakti se në tre vitet e fundit të mara për studim, vërehet se shpenzimet në përpjesëtim me numrin e punëtorëve janë në rënie e sipër. Ky është një sinjal dhe refleksion i rritjes së produktivitetit dhe efikasitetit në aktivitetin afarist të biznesit.

#### 4.4. Treguesit financiar dhe përmbledhja e tyre

Analiza horizontale dhe vertikale krahasojnë një zë me një zë tjetër të po të njëjtëskategori. Megjithatë, është e rëndësishme që të krahasohen edhe zërat e kategorive të ndryshme. Kjo realizohet përmes analizës së treguesve. Në vijim pra, duke shfrytëzuar të dhënat nga pasqyrat financiare të firmës “Banjat e Dibrës Capa”, do të llogarisim dhe analizojmë treguesit kryesor financiar, edhe atë:

##### Treguesit e likuiditetit:

1.  $Kapitali\ punues\ neto = Aktiv\et\ korente - pasiv\et\ korente$

2.  $Raport\i\ korente = \frac{Aktiv\et\ korente}{Pasiv\et\ korente}$

3.  $Test\i\ acid = \frac{Aktiv\et\ korente - inventar\et}{Pasiv\et\ korente}$

Pra, nëse i referohemi të dhënave nga bilanci i gjendjes, tabela 2, njehsojmë:

Viti	Aktivet afatshkurtra	Detyrimet afatshkurtra	Inventarët	Kapitali punues neto	Raporti korrent	Testi acid
2007	28,883,217	17,101,348	7,423,887	11,781,869	1.69 herë	1.25 herë
2008	26,185,571	12,796,520	9,164,618	13,389,051	2.05 herë	1.33 herë
2009	25,783,334	7,906,519	4,621,752	17,876,815	3.26 herë	2.68 herë
2010	28,281,201	7,070,445	5,135,679	21,210,756	4.00 herë	3.27 herë
2011	51,714,448	54,017,593	2,635,743	-2,303,145	0.96 herë	0.91 herë
2012	34,861,699	44,168,812	5,592,134	-9,307,113	0.79 herë	0.66 herë
2013	47,336,963	74,959,418	5,540,173	-27,622,455	0.63 herë	0.56 herë
2014	23,646,054	59,097,819	5,559,372	-35,451,765	0.40 herë	0.31 herë
2015	26,984,386	63,005,638	155,247	-36,021,252	0.43 herë	0.43 herë
2016	71,809,999	54,363,213	249,091	17,446,786	1.32 herë	1.32 herë
2017	42,512,465	61,575,280	3,318,911	-19,062,815	0.69 herë	0.64 herë

Tabela 22- Përpunim i autorit, Raportet e likuiditetit, 2007 – 2017

Figura në vazhdim prezanton dy treguesit e likuiditetit afatshkurtër, edhe atë raportin korrent dhe testin acid.




Figura 17- Përpunim i autorit, Raporti korrent & Testi acid, 2007 – 2017

**Treguesit e qarkullimit të aktiveve:**

$$1. \text{ Qarkullimi i inventarit} = \frac{\text{Shitjet}}{\text{Inventari}}$$

$$2. \text{ Qarkullim i aktiveve gjithsej} = \frac{\text{Shitjet}}{\text{Aktivet gjithsej}}$$

$$3. \text{ Qarkullimi i llogarive të arkëtueshme} = \frac{\text{Shitjet}}{\text{Llog e arkëtueshme}}$$

$$4. \text{ Periudha mesatare e arkëtimit} = \frac{\text{Llogaritë e arkëtueshme}}{\frac{\text{Shitjet}}{365}}$$

Viti	Shitjet	Inventari	Aktivet gjithsej	Detrimet rrydhëse	Llogaritë e arkëtueshme	Qarkullimi i inventarit	Qarkullimi i aktiveve	Qarkullimi i llogarive të arkëtueshme	Periudha mesatare e arkëtimit
2007	76,324,116	7,423,887	177,128,055	17,101,348	20,134,313	10.28 herë	0.43 herë	3.79	96 ditë
2008	83,600,195	9,164,618	184,169,929	12,796,520	16,329,245	9.12 herë	0.45 herë	5.12	71 ditë
2009	87,464,294	4,621,752	171,043,612	7,906,519	18,821,062	18.92 herë	0.51 herë	4.65	79 ditë
2010	100,906,601	5,135,679	173,497,816	7,070,445	22,434,806	19.65 herë	0.58 herë	4.50	81 ditë
2011	106,644,661	2,635,743	196,243,780	54,017,593	29,430,079	40.46 herë	0.54 herë	3.62	101 ditë
2012	120,814,255	5,592,134	229,509,721	44,168,812	28,119,006	21.60 herë	0.53 herë	4.30	85 ditë
2013	124,184,855	5,540,173	242,505,238	74,959,418	39,337,497	22.42 herë	0.51 herë	3.16	116 ditë
2014	131,777,940	5,559,372	232,612,198	59,097,819	12,909,135	23.70 herë	0.57 herë	10.21	36 ditë
2015	138,026,876	155,247	237,270,391	63,005,638	24,368,576	889.1 herë	0.58 herë	5.66	64 ditë
2016	154,189,302	249,091	309,649,747	54,363,213	11,563,982	619.0 herë	0.50 herë	13.33	27 ditë
2017	174,669,025	3,318,911	329,826,680	61,575,280	13,421,939	52.63 herë	0.53 herë	13.01	28 ditë

Tabela 23- Përpunim i autorit, Treguesit e qarkullimit të aktiveve, 2007 – 2017

### Treguesit e aftësisë paguese:

1.  $Raporti\ i\ borxhit = \frac{Detyrimet\ Gjithsej}{Aktivet\ Gjithsej}$
2.  $Raporti\ borxh - kapital\ i\ vet = \frac{Detyrimet\ Gjithsej}{Kapitali\ aksionar}$

Viti	Detyrimet gjithsej	Aktivet gjithsej	Kapitali aksionar	Raporti i borxhit	Raporti borxh/kapital
2007	77,427,246	175,728,055	98,300,809	0.44 herë	0.79 herë
2008	85,867,089	184,169,929	98,302,840	0.47 herë	0.87 herë
2009	71,684,753	171,043,612	99,358,859	0.42 herë	0.72 herë
2010	66,300,524	173,497,816	107,197,292	0.38 herë	0.62 herë
2011	88,612,081	196,243,780	107,631,699	0.45 herë	0.82 herë
2012	106,544,351	229,509,721	12,297,3370	0.46 herë	0.87 herë
2013	105,007,039	242,505,238	137,498,199	0.43 herë	0.76 herë
2014	81,480,349	232,612,198	151,161,849	0.35 herë	0.54 herë
2015	76,005,488	237,270,391	161,264,903	0.32 herë	0.47 herë
2016	123,787,799	309,649,747	185,861,948	0.40 herë	0.67 herë
2017	110,606,164	329,826,680	219,220,516	0.34 herë	0.50 herë

Tabela 24- Përpunim i autorit, Treguesit e aftësisë paguese, 2007 – 2017

### Treguesit e rentabilitetit:

1.  $Fitimi\ marxhinal\ bruto = \frac{Fitimi\ bruto}{Shitjet}$
2.  $Fitimi\ marxhinal\ neto = \frac{Fitimi\ neto}{Shitjet}$
3.  $Kthimi\ nga\ aktivet\ (ROI) = \frac{Fitimi\ neto}{Aktivet\ gjithsej}$
4.  $Kthimi\ nga\ kapitali\ i\ vet\ (ROE) = \frac{Fitimi\ neto}{Kapitali\ aksionar}$

Viti	Fitimi bruto	Fitimi neto	Shitjet	Aktivet gjithsej	Kapitali aksionar	Fitimi marxhinal bruto	Fitimi marxhinal neto	ROI	ROE
2007	971,374	884,832	76,324,116	175,728,055	98,300,809	1.3%	1.2%	0.5%	0.9%
2008	204,381	153,473	83,600,195	184,169,929	98,302,840	0.2%	0.2%	0.08%	0.15%
2009	1,079,231	1,056,019	87,464,294	171,043,612	99,358,859	1.2%	1.2%	0.61%	1.06%
2010	7,871,103	7,838,433	10,090,6601	173,497,816	107,197,292	7.8%	7.8%	4.51%	7.31%
2011	533,423	434,407	106,644,661	196,243,780	107,631,699	0.5%	0.4%	0.22%	0.4%
2012	15,488,696	15,333,670	120,814,255	229,509,721	122,973,370	12.8%	12.7%	6.68%	12.47%
2013	1,461,056	14,532,829	124,184,855	242,505,238	137,498,199	11.8%	11.7%	6.0%	10.6%
2014	15,108,335	13,633,650	131,777,940	232,612,198	151,161,849	11.5%	10.3%	5.9%	9.0%
2015	11,033,608	10,133,196	138,026,876	237,270,391	161,264,903	8.0%	7.3%	4.3%	6.3%
2016	29,627,978	26,487,045	154,189,302	309,649,747	185,861,948	19.2%	17.2%	8.6%	14.3%
2017	39,167,766	36,508,568	174,669,025	329,826,680	219,220,516	22.4%	20.9%	11.1%	16.7%

Tabela 25- Përpunim i autorit, Treguesit e rentabilitetit, 2007 – 2017




Figura 18- Përpunim i autorit, Kthimi nga aktivet (ROI) dhe parashikimi, 2007 – 2017






Figura 19 - Përpunim i autorit, Kthimi nga kapitali i vet (ROE) dhe parashikimi, (ROE), 2007-2017

Vitet	Raportet e likuiditetit			Raportet e qarkullimit të aktiveve				Raportet e aftësisë paguese		Raportet e rentabilitetit			
	Kapitali punues	Raporti korrent	Testi acid	Qarkullimi inventarit	Qarkullimi aktiveve	Qarkullimi logarive të arkëtueshme	Periudha mesatare arkëtimit (ditë)	Raporti i borxhit	Raporti borxh/kapital i vet	Fitimi marxhinal bruto	Fitimi marxhinal neto	ROI	ROE
2007	11,781,869	1.69	1.25	10.28	0.43	3.79	96	0.44	0.79	1.3%	1.2%	0.5%	0.9%
2008	13,389,051	2.05	1.33	9.12	0.45	5.12	71	0.47	0.87	0.2%	0.2%	0.1%	0.2%
2009	17,876,815	3.26	2.68	18.92	0.51	4.65	79	0.42	0.72	1.2%	1.2%	0.6%	1.1%
2010	21,210,756	4.00	3.27	19.65	0.58	4.50	81	0.38	0.62	7.8%	7.8%	4.5%	7.3%
2011	-2,303,145	0.96	0.91	40.46	0.54	3.62	101	0.45	0.82	0.5%	0.4%	0.2%	0.4%
2012	-9,307,113	0.79	0.66	21.60	0.53	4.30	85	0.46	0.87	12.8%	12.7%	6.7%	12.5%
2013	-27,622,455	0.63	0.56	22.42	0.51	3.16	116	0.43	0.76	11.8%	11.7%	6.0%	10.6%
2014	-35,451,765	0.40	0.31	23.70	0.57	10.21	36	0.35	0.54	11.5%	10.3%	5.9%	9.0%
2015	-36,021,252	0.43	0.43	889.08	0.58	5.66	64	0.32	0.47	8.0%	7.3%	4.3%	6.3%
2016	17,446,786	1.32	1.32	619.01	0.50	13.33	27	0.40	0.67	19.2%	17.2%	8.6%	14.3%
2017	-19,062,815	0.69	0.64	52.63	0.53	13.01	28	0.34	0.50	22.4%	20.9%	11.1%	16.7%

Tabela 26 – Përmbledhje e treguesve financiarë

#### **4.5. Diskutimi i rezultateve dhe implikimi biznesor**

Analiza horizontale, vertikale, analiza e trendit dhe matja e treguesve financiarë janë teknika moderne dhe efikase në analizën e performancës financiare dhe shërbejnë si bazë referimi në nxjerrjen e përfundimeve dhe marrjen e vendimeve të ardhshme biznesore. Pra, e gjithë ajo që u elaborua dhe të gjitha kalkulimet e realizuara në pjesën paraprake të këtij kreu, në vijim do të shtjellohen dhe diskutohen akoma më tej me qëllim që të mund ti ofrojmë lexuesit apo përdoruesit të informacionit kontabël një pasqyrë më të qartë të performancës financiare të firmës në fjalë, si dhe të nxjerrim përfundimet dhe ofrojmë sugjerimet e mundshme.

Nëse analizojmë aktivet fikse të firmës, shohim që në përgjithësi kemi rritje të vazhdueshme, me përjashtim në vitet 2009, 2010 dhe 2011, ku shihet se ka ulje prej 8.05%, 0.03% dhe 0.47% respektivisht, nga vitet paraprake (tabela 4). Vlera e aktiveve fikse zakonisht ka shënuar rënie si rezultat i shitjes së mjeteve materiale të firmës (për shkak të vjetërsimit dhe zhvlerësimit të tyre).

Ndërkaq, në vitin 2012 tregohet se ka një rritje të konsiderueshme prej 34.68% (tabela 5) në vlerën e aktiveve fikse në krahasim me vitin paraprak, e cila kryesisht vjen si pasojë e investimeve që firma ka realizuar në infrastrukturë. Vlen të theksohet se rritja në vlerë e aktiveve fikse ka vijuar edhe në vitet në vijim, me theks të veçantë në vitin 2016 ku ka një rritje prej 13.10% (tabela 7) dhe vitin 2017, për 20.80% më shumë në krahasim me vitin 2016 (tabela 7). Trendi i rritjes së aktiveve fikse është një indikator që dëshmon se firma gjatë periudhës në shqyrtim ka realizuar investime në infrastrukturë, gjë që sjell dhe rritjen në vlerën financiare të aktiveve fikse.

Më tej, në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007 pasuria rrjedhëse është zvogëluar për 4.7% ndërsa detyrimet afatshkurtra kanë rënë për 25% (tabela 4), që tregon se firma megjithatë është likuide. Në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008 pasuria rrjedhëse sërish ka rënë për 1.5%, ndërsa detyrimet afatshkurtra kanë rënë për 38% (tabela 4). Situata akoma më e mirë është në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009, ku shihet se pasuria rrjedhëse e firmës është rritur për 9.7%, ndërsa detyrimet afatshkurtra kanë rënë për 10% (tabela 4), që tregon një gjendje më të kënaqshme të likuiditetit në krahasim me vitet e mëparshme. Ndërkaq, likuiditeti ka rënë drastikisht në vitin 2011 në krahasim me vitin 2010, ku pasuria rrjedhëse është rritur për 82%, ndërsa detyrimet afatshkurtra për 664% (tabela 5). Situata e njëjtë ka vijuar edhe në vitet pasardhës ku likuiditeti i firmës vazhdon të jetë mjaft i dobët dhe përkeqësuar.

Megjithatë, gjendja është përmirësuar në vitin 2016, ku vërejmë se aktivet rrjedhëse janë rritur për 166% në krahasim me vitin 2015, ndërsa detyrimet afatshkurtra kanë rënë për 13% (tabela 7) në krahasim me vitin 2015. Në vitin 2017 në krahasim me vitin 2016 sërish kemi një përkeqësim të likuiditetit pasi vërejmë se aktivet rrjedhëse kanë pësuar rënie për 40.8%, ndërsa detyrimet afatshkurtra janë rritur për 13% (tabela 7).

Në anën tjetër, tek kapitali në krahasim me vitin paraprak bie në sy rritja prej 14.25% (tabela 5) në vitin 2012 në krahasim me vitin 2011, ndërsa fitimi neto ka rënë për 800.8% (tabela 8); si dhe viti 2017 ku shënohet rritje prej 17.95% (tabela 7) në krahasim me vitin 2016, kurse fitimi neto është rritur për 37.84% (tabela 11).

Në vazhdim, analiza vertikale tregon se parë nga këndvështrimi i kompozimit (strukturës) të aktiveve dhe pasiveve të firmës, likuiditeti i firmës gjatë viteve 2007 – 2010 është në gjendje përgjithësisht të mirë pasi aktivet afatshkurtra janë në vlerë ndjeshëm më të larta në krahasim me detyrimet afatshkurtra (tabela 12). Tregues pozitiv i kombinimit të analizës vertikale dhe më tej i

analizës së trendit është se aktiva e firmës sa vinë e rritet gjatë periudhës së analizuar, që dëshmon rritje të vetë firmës. Është aktiviteti dhe specifikat e biznesit që kanë çuar proporcion të tillë që aktivet afatgjata, edhe atë ato materiale të jenë dukshëm më të larta sesa aktivet afatshkurtra të firmës.

Relacioni aktive afatshkurtra – detyrime afatshkurtra, megjithatë ndryshon në vitin 2011 ku aktivet afatshkurtra janë rritur nga 16.30% në 26.35%, ndërsa detyrimet afatshkurtra po ashtu janë rritur nga 4.07% sa janë në vitin 2010 në 27.53% (tabela 13). Kjo nënkupton se likuiditeti i firmës ka rënë ndjeshëm (treguesi i kapitalit punues). Situata e njëjtë ka vijuar deri në vitin 2016 dhe ku vërejmë se situata është përmirësuar pasi aktivet afatshkurtra janë rritur në 23.19% nga 11.37% në vitin 2016, ndërsa detyrimet afatshkurtra kanë rënë në 17.56% (% strukturore, shih tabelën 14) nga 26.55%. Rezultati në fjalë tregon se likuiditeti afatshkurtër i firmës është në gjendje përgjithësisht të mirë.

Më tej, gjendja e likuiditetit ka ndryshuar në vitin 2017, pasi aktivet afatshkurtra kanë rënë në 12.89% ndërsa detyrimet afatshkurtra janë rritur në 18.67% (tabela 14), që tregon se likuiditeti i firmës është përkeqësuar.

Por, për sa i përket pasurisë fikse të firmës, nuk vërehen oscilacione apo shmangie shumë të mëdha në bilancin e gjendjes (analizuar nga perspektiva e përqindjeve strukturore) gjatë periudhës krahasuese. Megjithatë, vlen të theksohet se vlera më e lartë është në vitin 2014 ku pasuria fikse paraqet 89.83% nga gjithsej pasuria e firmës, ndërsa më e ulët në vitin 2011, ku vlera në përqindje është 83.70%.

Në strukturën e kapitalit dhe detyrimeve, vërejmë se kapitali në proporcion me detyrimet është në rritje e sipër nga viti në vit. Nëse analizojmë dy ekstremet në aspekt kohor, konstatohet se vitin 2007 kapitali dhe rezervat përbëjnë 55.93% të pasivit, ndërsa detyrimet 44.07%. Sakaq, në vitin 2017, kapitali dhe rezervat përbëjnë 66.47%, ndërsa detyrimet janë 33.53%.

Në vazhdim, ashtu siç u shpjegua edhe nga pikëpamja teorike por edhe nga të dhënat kontabël praktikë, performanca financiare dhe analiza e saj nuk mund të bëhet e pavarur nga të dhënat e bilancit të gjendjes në rradhë të parë (nga perspektiva mikroekonomike dhe mikrofinanciare).

Andaj, analizat tregojnë se në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve mund të vërejmë rritjen e dukshme në fitimin neto nga 1.12% në vitin 2009 në 7.75% në vitin 2010 si pasojë e rritjes së të hyrave nga shitja në 99.79% si dhe rënies së shpenzimeve në 92.22% nga 98.86% në vitin 2009 (tabela 15). Megjithatë, në vitin 2011 fitimi neto shënon 0.41% për shkak të rritjes së shpenzimeve operative në 99.50% (tabela 16). Normë të lartë të fitimit kemi në vitin 2016 prej 19.15% për shkak se shpenzimet operative kanë rënë në 80.85% (tabela 17) dhe në vitin 2017 ku fitimi neto është 22.37%, ndërsa shpenzimet operative shënojnë 77.63% (tabela 17) në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve (bilancin e suksesit).

E rëndësishme në mënyrë të përmbledhur është se katër treguesit me të cilët u matë performanca financiare (krahas treguesve dhe analizave tjera) tregojnë përgjithësisht një përmirësim të saj parë nga këndvështrimi i trendit, edhe atë:

- Fitimi marxhinal bruto (ekuacioni i trendit:  $y = 0.020x - 0.032$ ,  $R^2 = 0.757$ ),
- Fitimi marxhinal neto (ekuacioni i trendit:  $y = -0.014x + 0.275$ ,  $R^2 = 0.018$ ),
- Kthimi nga investimet ROI (ekuacioni i trendit:  $y = 0.009x - 0.014$ ,  $R^2 = 0.748$ ) dhe
- Kthimi nga kapitali ROE (ekuacioni i trendit:  $y = 0.015x - 0.018$ ,  $R^2 = 0.691$ ).

Në qoftë se vërehen rezultatet e mësipërm, fitimi marxhinal bruto, kthimi nga aktivet dhe kthimi nga kapitali kanë trende pozitive dhe me tregues statistikor ( $R^2$ ) të kënaqshëm. Është pjesa e fitimit neto si tregues që nuk tregon  $R^2$  të pranuar.

Megjithatë, dy treguesit me mjaftë interes për pronarët e biznesit (aksionarët), ROI dhe ROE kanë një trend mjaft shpresëdhënës dhe që sinjalizojnë se performanca e biznesit sa ka ardhur është përmirësuar me kalimin e viteve.

Më tej, në kuadër të analizës së treguesve financiar janë ofruar të dhëna dhe rezultate relevante mbi performancën financiare të firmës. Gjithsej janë përlllogaritur dhe analizuar 13 tregues financiar nga të dhënat e ofruara në bilancin e gjendjes dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në mënyrë të përmblëdhur analiza e treguesve financiarë, krahas diskutimeve të mësipërme, nxjerrë në sipërfaqe implikimet vijuese biznesore.

- Neto kapitali punues – është cekur dhe më sipër se ky raport paraqet ndryshimin mes pasurisë rrjedhëse dhe detyrimeve rrjedhëse. Mund të konkludojmë se ky raport ka qenë pozitiv nga viti 2007 deri në vitin 2010, ndërsa nga viti 2011 deri në vitin 2015 trendi ka qenë negativ nga viti në vit, duke arritur në (-) 36,021,252 denarë në vitin 2015. Kjo do të thotë se firma gjatë kësaj periudhe nuk i ka harmonizuar mirë politikat menaxhuese të mjeteve qarkulluese me detyrimet afatshkurtra. Kapitali punues është rritur ndjeshëm në vitin 2016 dhe ka vlerë pozitive, ndërsa ka rënë sërish në vitin 2017.

- Raporti korrent apo siç njihet ndryshe si likuiditeti i rrjedhshëm është në rritje progresive nga viti 2007 deri në vitin 2010 kur vlera e koeficientit ka kulmuar me 4.0, që paraqet një gjendje të mirë financiare. Megjithatë, ky koeficient ka rënë viteve pasues, ku shihet se detyrimet afatshkurtra janë rritur ndjeshëm në proporcion me pasurinë qarkulluese. Gjithnjë duke iu referuar rezultateve vërejmë se vlera e treguesit është rritur sërish në vitin 2016 nga 0.43 në 1.32, pasi detyrimet afatshkurtra kanë rrënë në krahasim me vitin paraprak ndërsa pasuria rrjedhëse është rritur ndjeshëm. E kundërta ndodh në vitin 2017 dhe si pasojë kemi edhe përqesim të likuiditeti rrjedhës të firmës.

- Si indikator më relevant dhe më preciz mbi aftësinë e firmës për të shlyer detyrimet rrjedhëse me pasurinë rrjedhëse konsiderohet testi acid. Për firmën në fjalë, duke u bazuar në rezultatet e fituara, mund të themi se konkluzionet e nxjerra më sipër vlejné edhe këtu, pra gjendja e likuiditeti është përgjithësisht e mirë gjatë viteve 2007-2010. Më pas treguesi në fjalë bie ndjeshëm nga viti 2011 deri në vitin 2015. Situata përmirësohet në vitin 2016 dhe më pas sërish kemi një rrënie në likuiditet në vitin 2017. Megjithatë, vlen të theksohet se vlera e treguesit të testit acid është deri diku më e ulët në krahasim me raportin korrent pasi ky tregues merr parasysh vetëm aktivet më likuide dhe që mund të shndërrohen fare lehtë në para të gatshme, pra nga aktivet zbriten inventarët dhe shpenzimet e parapaguara.

- Qarkullimi i inventarit – tregon se sa herë është zëvendësuar malli i shitur brenda vitit, pra sa lehtë e ka firma që të shndërrojë mallin në shitje. Nga rezultatet e fituara bie në sy treguesi tepër i lartë në vitet 2015 dhe 2016, pasi firma i ka reduktuar ndjeshëm inventarët gjatë këtyre viteve.

- Raporti i qarkullimit të aktiveve tregon nëse firma menaxhon me efikasitet aktivet e saja për të realizuar shitje. Nga rezultatet e fituara tregohet se gjatë periudhës në shqyrtim, pavarësisht se treguesi nuk është shumë i lartë, mund të themi se firma po menaxhon deri diku mirë me pasurinë e saj në funksion të realizimit të shitjeve.

- Qarkullimi i llogarive të arkëtueshme – tregon sa herë brenda një viti fiskal llogaritë e arkëtueshme shndërrohen në para. Për shembull, treguesi prej 4.3 herë tregon se brenda vitit llogaritë

e arkëtueshme janë shndërruar në para 4.3 herë, apo përafërsisht një here në tre muaj. Bie në sy fakti se në vitin 2010 firma ka arritur të shndërrojë (konvertojë) llogaritë e arkëtueshme 10.21 herë, ndërsa në vitet 2016 dhe 2017 13.33 dhe 13.01 herë respektivisht. Këto janë tregues mjaft të kënaqshëm përgjithësisht pasi firma gjatë këtyre viteve ka arkëtuar kërkesat në më pak se një muaj.

- Periudha mesatare e arkëtimit tregon në mënyrë më precize se sa ditë i nevojiten firmës për të arkëtuar kërkesat nga blerësit. Nga rezultatet e fituara tregohet se situata ka qenë më keq në vitin 2013, 116 ditë, ndërsa më mirë në vitin 2016, 27 ditë.

- Raporti i borxhit ndaj aktiveve tregon në përqindje aktivet apo mjetet e mbuluara me borxh, qoftë ky afatshkurtër apo afatgjatë. Borxhi i lartë paraqet risk për investitorët, përderisa nuk shfrytëzohet siç duhet në gjenerimin e shitjeve dhe rritjen e biznesit. Sipas të dhënave treguesi në fjalë ndryshon nga viti në vit, por vlen të theksohet se nuk është shumë i lartë duke patur parasysh industrinë në të cilën operon firma. Vlera më e lartë është në vitin 2008, 47%, ndërsa më e ulët në vitin 2015, 32%.

- Raporti i borxhit ndaj kapitalit tregon në përqindje sasinë e borxhit në strukturën e kapitalit të firmës. Interpretimi i këtij treguesi varet nga disa faktorë, por gjithnjë duke iu referuar rezultateve nga tabela përmbyllëse, tregohet se gjatë viteve të para ky raport ka qenë relativisht i lartë, ndërsa viteve të fundit ka rënë disi. Në vitin 2007 treguesi ka qenë 0.79 dhe më pas 0.87 në 2008, ndërsa në vitin 2017 shënon 0.50.

- Fitimi marxhinal bruto – rezultat tregojnë se në vitet e para ky tregues është relativisht i ulët, pra 1.3%, 0.2% dhe 1.2% në vitet 2007, 2008 dhe 2009 respektivisht. Më pas treguesi ndjeshëm rritet në vitet në vijim dhe ka arritur 19.2% në vitin 2016 dhe 22.4% në vitin 2017, që tregon një përmirësim të konsiderueshëm.

- Fitimi marxhinal neto – tregon në përqindje fitimet e pastra që i ngelin firmës pasi të ketë shlyer të gjitha shpenzimet operative, duke përfshirë edhe interesin dhe tatimet. Komentimi mbi ecurinë e këtij treguesi për subjektin në fjalë është relativisht i njëjtë me interpretimin e mësipërm, megjithëse kuptohet që treguesi këtu është diçka më i ulët për shkak se nga fitimi bruto është zbritur tatimi.

- Kthimi në pasuri apo siç njihet në literaturën e financave si ROI, tregon se sa para neto janë fituar për çdo denarë të pasurisë që firma ka investuar në biznes. Nga rezultatet e fituara vërejmë se në vitet e para treguesi është më pak se 1%, që normalisht nuk është një tregues i kënaqshëm. Megjithatë, vërejmë se kjo ka ndryshuar viteve në vijim e veçanërisht në dy vitet e fundit, pra vitet 2016 dhe 2017, ku norma e kthimit nga aktivet (investimet) është 8.6% dhe 11.1% respektivisht.

- ROE apo ndryshe kthimi nga kapitali i vet tregon normën e kthimit të fituar nga kapitali i aksionarëve. Në vitin 2007 dhe 2008 norma e kthimit është 0.9% dhe 0.2% respektivisht, në vitin 2009 është 1.1%, ndërsa në vitin 2010 tregohet një rritje në 7.3%. Treguesi bie në vitin 2011 në 0.4%, ndërsa kemi një rritje të konsiderueshme në dy vitet pasuese në 12.5% dhe 10.6% respektivisht. Në vitin 2014 dhe 2015 norma e kthimit ka rënë në 9.0% dhe 6.3%, ndërsa në vitet 2016 dhe 2017 kemi një rritje të konsiderueshme të kthimit nga kapitali në 14.3% dhe 16.7% respektivisht. Rezultati i favorshëm i arritur vitet e fundit të operimit biznesor është në harmoni edhe me pritjet menaxheriale dhe të aksionarëve si rrjedhojë e investimeve të realizuara afatgjata nga firma.

## KREU V. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

### 5.1. Përfundimet

Nga analizat e realizuara rezultoi se trendi i performancës financiare të firmës “Banjat e Dibrës Capa”, për periudhën 2007-2017” kryesisht ka qenë pozitiv, kundrejt ulje ngritjeve nga viti në vit.

Të dhënat e ofruara dhe rezultatet e fituara gjatë studimit na shpjen drejt konkluzionit se firma gjatë periudhës të marrë në shqyrtim ka qenë gjithnjë likuide, dhe në këtë aspekt, nuk e ka patur të nevojshme që të zhytet në detyrimet financiare shtesë, pasi pasuria qarkulluese ka qenë vazhdimisht e mjaftueshme për të mbuluar detyrimet qarkulluese.

Në vazhdim të asaj që u tha më sipër, për tu përshëndetur është fakti që firma ka filluar aplikojë politika efikase në funksion të arkëtimit të kërkesave, si çelësi kryesor në mbarëvajtjen e likuiditetit të firmës.

Përgjatë periudhës të marrë në shqyrtim, pasuria fikse e firmës nga viti në vit është rritur ndjeshëm dhe madje pothuajse është dy shifruar në qoftë se krahasojmë të dhënat për vitin e parë dhe vitin e fundit, që dëshmon për investimet e vazhdueshme që firma ka realizuar gjatë kësaj periudhe në infrastrukturë dhe përmirësimin e kushteve dhe shërbimeve që ofron.

Për sa i përket fitimit, që në fund të fundit është edhe ajo që ka rëndësi më të madhe në çdo biznes, veçanërisht për aksionaret, rezultatet janë përmirësuar dukshëm. Kjo mund të konkludohet lehtë ku u tregua se fitimi neto në terma monetar gjatë viteve të fundit të studimit është dukshëm më i lartë në krahasim me vitet e para.

Kështu, studimi krahas objektivit bazë që kishte për analizën e performancës së biznesit mund të përgjigjet në pyetjet hulumtuese të parashtruara duke treguar se gjatë periudhës së analizës:

- Performanca e biznesit është përmirësuar dhe ajo aktuale është mjaft e kënaqshme (ROI = 11%, ROE = 17%, fitimi marxhinal bruto = 22%, fitimi marxhinal neto = 21%);
- Biznesi ka një nivel të likuiditetit të pranuar përgjithësisht ku dëshmohet se aktivitetet mbulohen me përqindje më të lartë nga kapitali kundrejt detyrimeve;
- Aktualisht, por edhe në vitet paraprake biznesi ka qenë profitabile. Por, me rëndësi të theksohet është fakti se trendi i profitabilitetit është pozitiv dhe mjaft shpresëdhënës. Krahas, rezultateve të prezantuara më herët, një rezultat tjetër mbështetës në funksion të kësaj është raporti në mes fitimit neto dhe numrit të punësuarve ku trendi tregon ekuacionin si:  $y = 20646x - 39859$ ,  $R^2 = 0.767$ ). Rezultatet tregojnë se ky raport në dy vitet e fundit është 189,193, respektivisht 232,539 denarë fitim neto për të punësuar.
- Në fund, tregohet një lidhje negative në mes profitabilitetit dhe likuiditetit të biznesit. Rezultatet tregojnë se korrelacioni në mes ROI dhe testit acid është -0.33; në mes ROI dhe raportit korrent është -0.40; ROE dhe testit acid është -0.33; ROE dhe raportit korrent është -0.40. Mbase edhe politikat menaxhuese të financave të firmës që kanë ulur dy treguesit në fjalë të likuiditetit kanë patur për bazë dhe objektiv rritjen në anën tjetër të profitabilitetit, gjë e cila konstatohet me rezultatet faktike financiare.

Dhënia e përgjigjeve të mësipërme njëkohësisht argumenton edhe konstatimin se performanca financiare është përmirësuar dhe ky përmirësim ka ardhur si rezultat i investimeve në infrastrukturë

(hipoteza e parë). Rritja e profitabilitetit dhe sidomos tregueseve ROI dhe ROE në një rën anë dhe pasurisë fikse në anën tjetër është shoqëruar me një korrelacion pozitiv, edhe atë 0.90, respektivisht 0.86.

Më tej, dihet se sa më shumë të investohet, aq më i lartë është dhe risku i humbjes. Ndërsa nga ana tjetër, sa më i lartë të jetë risku, aq më i lartë është edhe kthimi (fitimi). Çdo investim shoqërohet me raportin risk/kthim, prandaj më herët kemi ngritur edhe hipotezën e dytë të studimit se raporti risk dhe kthim nga investimet në infrastrukturë është në harmoni me pritshmërinë e vendimmarrësve menaxherial dhe aksionarëve.

Përveç argumentimit nga pikëpamja e analizës së pasqyrave financiare dhe prezantimit madje edhe të korrelacioneve përkatëse se megjithatë ia ka vlejtur që të realizohen investimet në fjalë, është marrë edhe një opinion/përgjigje nga drejtori ekzekutiv dhe njëkohësisht një ndër aksionarët më të mëdhenj. Sipas aksionarit në fjalë, i cili është dakord me hipotezën e parashtruar se me të vërtetë performanca financiare është përmirësuar dukshëm si pasojë e investimeve të vazhdueshme në funksion të përmirësimit të kushteve infrastrukturore, ai shton edhe disa pikëpamje shtesë në këtë drejtim. Sipas tij duke patur parasysh se para privatizimit, një kohë të gjatë nuk ishte investuar në infrastrukturë, pronarët e rinj e panë të domosdoshme që të ndërhyjnë në përmirësimin e kushteve dhe shërbimeve me qëllim të rigjallërimit të biznesit dhe normalisht, realizimit të fitimeve më të larta. Natyrisht, vendimi për të investuar është marrë vetëm pasi janë analizuar një sërë faktorësh direkt dhe indirekt, dhe pavarësisht faktit se janë investuar shuma të mëdha parash dhe riskut që e shoqëron, mësojmë se pronarët kanë qenë të bindur se investimi i realizuar do të kthejë fitime të larta. Ai shprehet i kënaqur me kthimin nga investimi deri tani dhe duke parë trendin është optimist se në vitet në vijim firma do të realizojë fitime edhe më të larta. Pritshmëria optimiste mbështetet edhe në argumentimet dhe pasqyrimin e rezultateve të mëparshme financiare.

Në vazhdim, drejtori shton se pavarësisht se firma “Banjat e Dibrës – Capa”, viteve të fundit ka hedhur hapa të mëdha në krahasim me konkurrentët në funksion të shërbimeve që ofrohen, firma ka ndjekur një politikë mjaft korrekte të çmimeve, duke pasur vazhdimisht parasysh çmimet në nivel industri por edhe mundësinë e klientëve në rajon. Duke qenë te politika e çmimeve, ai shton se klientit i ofrohen paketa të ndryshme, normalisht me çmime të ndryshme, ku vetë klienti mund të zgjedh për llojet e shërbimeve që dëshiron të pranojë. Këtu gjithashtu duhet theksuar se firma “Banjat e Dibrës – Capa” është e kyçur në planin qeveritar ku përmes “Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të RMV-së”, përfituesve të pensionit iu mundësohet shfrytëzimi i rekreacionit klimaterik në banjë. Ky shërbim është pa pagesë për klientin pasi shpenzimet mbulojnë nga “Ministria për punë dhe politika sociale”. Drejtori shprehet mjaft i kënaqur nga ky bashkëpunim dhe është optimist që ky projekt të vazhdojë edhe në të ardhmen, duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e pensionistëve preferojnë ujërat shëruuese të banjave të Dibrës, e megjithatë mësojmë se firma përpilon çdo vit plan në lidhje me periudhën dhe numrin e pensionistëve që mund të akomodojë.

Siç u përmend edhe më sipër, gjatë periudhës së marrë në shqyrtim personeli i firmës është rritur ndjeshëm nga viti në vit. Sipas drejtorit, firma ofron paketa kompensimi mjaft tërheqëse me qëllim thithjen e profesionistëve të kualifikuar, e megjithatë numri i ulët i banorëve në rrethinë por edhe largimi gjithnjë e në rritje i rinisë është një shqetësim i vazhdueshëm. Ai gjithashtu shton se është në interes të përbashkët që personeli mjekësor të ndjekë trajnime të ndryshme profesionale dhe se firma çdo vit akordon një pjesë të caktuar të buxhetit për avancim profesional të personelit.

## **5.2. Rekomandimet**

Mbajtja e tregueseve të tillë të performancës financiare dhe me qëllim të përmirësimit akoma më shumë në të ardhmen duhet të jetë e sinkronizuar dhe bashkërenditur me ruajtjen e stabilitetit financiar që reflektohet në strukturën e aktives dhe kryesisht të pasives.

Gjetja e burimeve alternative financuese dhe analiza e kostos së financimit të aktivitetit afarist, respektivisht të aktiveve të firmës, kompozimi i strukturës së kapitalit kundrejt performancës financiare në rritje, struktura e të ardhurave dhe shpenzimeve, etj. janë disa nga çështjet të cilat duhet mbajtur nën mbikëqyrje dhe që tu përgjigjen kërkesave që vinë nga tregu dhe faktorët e jashtëm makroekonomik përmes një menaxhimi strategjikë efikas të financave të firmës.

## **5.3 Kufizimet e punimit dhe sugjerimet për të ardhmen**

Ky punim masteri ka kufizimet e tij dhe për të ardhmen sugjerohet si vijon:

- Të zbatohen analiza dhe modele ende më të avancuara statistikore dhe ekonometrie që do të shpjegojnë ende më shumë faktorët që kanë afektuar performancën financiare;
- Të analizohet dhe krahasohet performanca financiare dhe ecuria e biznesit në përgjithësi kundrejt konkurrentëve/sectorit ku biznesi ushtron aktivitetin.



## Referencat

(WTTC), W. T. (2018). *Travel & Tourism Economic Impact 2018 Macedonia*.

*bdcapa.com*. (a.d.). Gjetur në <http://bdcapa.com/>

Brown, R. (2006). *Analiza e Pasqyrave Financiare*.

Dhamo, S. (2005). *Kontabiliteti i Avancuar*. Tiranë.

Govori, F. (2012). *Analiza e pasqyrave financiare: Përdoruesit e treguesve financiarë*. Pejë.

Hannuksela, J. (2018). *Financial Ratio Analysis case Supercell LTD*”.

*Investopedia.com*. (a.d.). Gjetur në <https://www.investopedia.com/terms/h/horizontalanalysis.asp>

Karapici, V. (2002). *Analiza Financiare*. Tiranë: SHBLU.

Kohl & Partner. (2016). *National Tourism Strategy, Republic of Macedonia*. Shkup.

*macedonia-timeless.com*. (a.d.). Gjetur në [https://macedonia-timeless.com/alb/rreth\\_nesh/rreth\\_nesh/turizmi-ne-maqedoni/](https://macedonia-timeless.com/alb/rreth_nesh/rreth_nesh/turizmi-ne-maqedoni/)

*mk.wikipedia.org*. (a.d.). Gjetur në [https://mk.wikipedia.org/wiki/%D0%91%D0%B0%D1%9A%D0%B0\\_%D0%91%D0%B0%D0%BD%D1%81%D0%BA%D0%BE](https://mk.wikipedia.org/wiki/%D0%91%D0%B0%D1%9A%D0%B0_%D0%91%D0%B0%D0%BD%D1%81%D0%BA%D0%BE)

*mn.mk.com*. (a.d.). Gjetur në Turizmi Banjar: <http://www.mn.mk/kultura/3905>

Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri - Perëndimore. (2018). *TOP 100 2018*. Shkup: Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri - Perëndimore.

Pendrill, David; Lewis, Richard. (2004). *Advanced Financial accounting, edicioni i shtatë*.

Rath, S. K. (2016). *Financial Analysis of Tata Steel*. *Quest Journal*.

Skorpnik, D. (2016). *Financial Analysis of a company Thermotemp, spol.s.r.o.*

(a.d.). *Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit*.

Tashkov, Nako; Metodijeski, Dejan. (2014). *Turizmi Termal*. Shtip.

Të dhëna nga arkivi i firmës. (a.d.).

Xhafa, H. (2010). *Drejtimi Financiar*”. Tiranë: Botimet Kumi.